



STRATEGJIA NDËRSEKTORIALE E REFORMËS NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

2015 – 2020

Raporti Vjetor i Monitorimit

2018

Tiranë, Mars 2019

Pasqyra e Lëndës

I. Përmbledhje Ekzekutive.....	4
II. Hyrje.....	9
III. Vlerësim i përgjithshëm mbi progresin e strategjisë	11
IV. Progresi i zbatimit të reformave në kuadër të secilit prioritet	15
<i>Shtylla I: Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit</i>	15
Progresi kundrejt secilit objektivi:	15
<i>Shtylla II: Organizimi dhe Funksionimi i Administratës Publike</i>	25
Progresi kundrejt secilit objektivi.....	25
<i>Shtylla III Shërbimi civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore</i>	34
Progresi kundrejt secilit objektivi.....	34
<i>Shtylla IV – Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja</i>	52
Progresi kundrejt secilit objektivi.....	52
V. Sfidat kryesore për zbatimin e Strategjisë në 2019	67

LISTA E AKRONIMEVE:

ADISA	Agjensia e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara
AFMIS	Sistemi i Menaxhimit Financiar
BE	Bashkimi European
DAP	Departamenti i Administratës Publike
EAMIS	Sistemi i Menaxhimit të Asistencës së Huaj
HRMIS	Sistemi Informatik i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore
IPSIS	Sistemi i Planifikimit të Integruar të Menaxhimit të Informacionit
IPS	Sistemi i Planifikimit të Integruar
KDIMDP	Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale
KE	Komisioni European
KPI	Indikatorët Kyç të Performancës
KPP	Komiteti i Përhershëm i Pranimi
ML	Ministri Linje
NC	Nëpunës Civil
OECD	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik
OJF	Organizatë Jofitimprurëse
OSS	One Single System (Një Sistem i Vetëm)
OZHM	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PFM	Menaxhimi i Financave Publike
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin European
RENjK	Regjistri Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik

RIA	Vlerësimi i Ndikimit Rregullator
SIGMA/OECD	Support for Improvement in Governance and Management
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SNRAP	Strategjia Ndërsektorale e Reformës në Administratën Publike
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit

I. Përmbledhje Ekzekutive

Raporti vjetor i monitorimit të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2015- 2020 ka për qëllim të prezantojë progresin e përgjithshëm të zbatimit të Strategjisë bazuar në katër shtyllat kryesore të saj si dhe nivelin e arritjes së objektivave respektive për vitin 2018.

Gjatë vitit 2018, puna për zbatimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike është fokusuar në dy drejtime kryesore: (i) hartimin dhe finalizimin e planit të ri të aktiviteteve dhe (ii) zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në strategji për periudhën 2018 – 2020.

Sikurse përcaktohet edhe në dokumentin strategjik të miratuar në 15 Prill 2015, strategjia iu nënshtua një procesi vlerësimi afatmesëm, i cili përfundoi në tremujorin e dytë të vitit 2017. Vlerësimi përfshiu periudhën 2015-2017 dhe shërbeu për të evidentuar arritjet gjatë dy viteve të para të zbatimit të strategjisë në pikëpamje të rezultateve të parashikuara dhe të nivelit të arritjes së objektivave. Ky vlerësim shërbeu gjithashtu edhe si një bazë e mirë, orientuese për përcaktimin e prioritetëve për periudhën 2018-2020, si dhe për të evidentuar nevojën e rishikimit të treguesve apo objektivave të parashikuara.

Në vijim të vlerësimit afatmesëm si dhe ristrukturimit të administratës qendrore shtetërore, Departamenti i Administratës Publike, me mbështetjen e OECD/SIGMA, nisi punën për hartimin e Planit të Ri të Veprimit 2018-2020, proces ky i cili filloi gjatë tremujorit të katërt të vitit 2017.

Gjatë hartimit të këtij plani, u morën në konsideratë arritjet dhe sfidat e hasura gjatë zbatimit të Strategjisë bazuar në gjetjet dhe rekomandimet e reflektuara në vlerësimin afatmesëm. Ndër të tjera, gjatë fazës së hartimit të aktiviteteve të reja, u konsideruan dhe reflektuan rast pas rasti rekomandimet e Raportit Vjetor të Komisionit Europian për Shqipërinë, vlerësimi vjetor i SIGMA, konkluzionet e takimit të shtatë të Grupit të Posaçëm për Reformën në Administratën Publike¹, si dhe prioritetet e kabinetit të ri qeveritar. Kujdes u tregua edhe ndaj evidentimit të aktiviteteve të paralelizuar gjatë periudhës 2015-2017, për t'u përfshirë në planin e ri të aktiviteteve. Fokus i veçantë iu kushtua financimit të aktiviteteve për të siguruar që plani i ri të bazohet në burime të qarta financiare dhe me një nivel shumë të ulët të boshllëkut financiar duke garantuar kështu qëndrueshmërinë financiare të planit që në hartimin e tij.

Plani i Ri i Veprimit për periudhën 2018-2020 reflektoi ndryshime të mundshme të aktiviteteve duke i kushtuar vëmendje të veçantë afateve kohore dhe burimeve të financimit për realizimin e masave për të siguruar një Plan të Ri Veprimi sa ambicioz aq edhe të arritshëm.

Pas bashkëpunimit me të gjitha institucionet, pjesë të kësaj Strategjie, draft-plani i hartuar bashkarisht u publikua në faqen e DAP (www.dap.gov.al) dhe të gjithë të interesuarit u ftuan për të dhënë komentet dhe sugjerimet e tyre mbi këtë plan². Për më tepër, gjatë muajit Prill 2018, Zëvendëskryeministri dhe Departamenti i Administratës Publike organizuan dy tryeza

¹ Takimi i Shtatë të Grupit të Posaçëm për Reformën në Administratën Publike BE-Shqipëri, u zhvillua në Tiranë më datë 27 Shtator, 2017

² <http://dap.gov.al/publikime/dokumenta-strategjik/186-test-rdraft-plani-i-ri-i-aktiviteteve-2018-2020>

konsultimesh me shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë për të diskutuar mbi planin e ri të aktiviteteve dhe për të finalizuar këtë dokument të rëndësishëm në bashkëpunim me të gjitha grupet e interesit. Pas miratimit në Grupin e Menaxhimit të Integruar të Politikave, Planin e Aktiviteteve 2018-2020 u miratua me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 447 datë 26.07.2018.

Paralelisht me punën përgatitore për hartimin e planit të ri të aktiviteteve, Departamenti i Administratës Publike ka vijuar monitorimin e ecurisë së aktiviteteve në mënyrë periodike përgjatë gjithë vitit.

Gjetjet e raportit vjetor për vitin 2018 janë inkurajuese pavarësisht se zbatimi i planit të ri 2018-2020 është në vitin e tij të parë. Të dhënat tregojnë se 87% e të gjitha aktiviteteve të parashikuara në Planin e Aktiviteteve 2018-2020 janë nën zbatim.

Në pikëpamje të përmirësimit të sistemit politikbërës dhe cilësisë së legjislacionit, Shqipëria ka vijuar të ndër marrë hapat e nevojshëm për të zbatuar sistemin e Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA)³. U përcaktuan projektligjet që do t'i nënshtrohen procesit të vlerësimit në ndikim, për vitin 2018. Gjithsej janë përcaktuar 13 projektligje për t'iu nënshtroar procesit të vlerësimit të ndikimit dhe ministritë e linjës kanë hartuar raportet e vlerësimit.

Ka patur ecuri pozitive në drejtim të ngritjes së sistemeve të menaxhimit të informacionit që do të ndikojnë në përmirësimin e planifikimit dhe koordinimit të politikave: IPSIS⁴, AFMIS⁵ dhe EAMIS⁶. Gjithashtu është finalizuar rishikimi i bazës ligjore dhe kuadrit rregullator për funksionimin e GMIP-ve⁷ për të adresuar sfidat lidhur me ndryshimet në strukturat e qeverisë dhe të funksioneve të tyre⁸.

Zhvillime janë bërë edhe sa i takon plotësimin të mekanizmave ligjore dhe institucionale që sigurojnë pjesëmarrjen e publikut në konsultimin e politikave publike. Rrjeti i koordinatorëve është ngritur në çdo ministri të linjës si dhe ka nisur puna për përgatitjen e udhëzimeve operacionale për ministritë e linjës për kryerjen e procesit të konsultimit publik dhe funksionimin e e-regjistrimit të konsultimit publik. Gjithashtu, në muajin Tetor të vitit 2018, u zhvillua një mision me ekspertët e SIGMA të cilët asistojnë në hartimin e kuadrit metodologjik dhe në hartimin e një drafti të parë i metodologjisë së konsultimit publik.

Në drejtim të përmirësimit të mënyrës së organizimit dhe funksionimit të administratës publike, ***është rikonceptuar mënyra sesi ofrohen shërbimet për qytetarët, me një përjasje gjithëpërfshirëse dhe të qendëruar tek qytetari.*** Për këtë qëllim, gjatë vitit 2018 nisi puna për vënien në zbatim të modelit të ri të organizimit të institucioneve në varësi të tre sistemeve pilot. Me urdhrin nr. 59 datë 26.03.2018 të Kryeministrit “Për ngritjen e strukturave për reformën

3 Kjo praktikë synon përmirësimin cilësor të praktikave të zhvillimit të politikave, si dhe kryerjen e analizave më të thelluara të akteve ligjore, para miratimit të tyre.

4 Sistemi i Planifikimit të Integruar të Menaxhimit të Informacionit

5 Sistemi i Menaxhimit Financiar

6 Sistemi i Menaxhimit të Asistencës së Huaj

7 Grupet e Menaxhimit të Integruar të Politikave

8 Urdhri Nr. 157, datë 22.10.2018 “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”.

strukturore në qeverisje” u ngritën strukturat e udhëheqjes, drejtimit, menaxhimit dhe të punës për ristrukturimin e institucioneve të varësisë. Reforma e institucioneve të varësisë është një proces i cili kryhet në kuadër të projektit për bashkëqeverisjen me qytetarët, të nisur me riorganizimin institucional, rishikimin e funksioneve të të gjitha institucioneve të varësisë, përfshirë inspektoratet, me qëllim ristrukturimin e tyre për të rritur performancën e administratës, cilësinë e shërbimit ndaj qytetarit dhe shtrirjen e duhur territoriale. Në zbatim të këtij urdhri u ngritën (i) struktura udhëheqëse; (ii) komiteti drejtues; (iii) grupi i menaxhimit; (iv) grupi qendror i punës; dhe (v) grupet teknike të punës pranë ministrive.

Puna ka filluar me reformimin e institucioneve të sistemit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrotjtjes Sociale që lidhen me shëndetin publik, i cili do të shërbejë edhe si model organizmi për ministritë e tjera. Gjithashtu janë hartuar dhe projektvendime sa i takon disa sistemeve të tjera ministriore si financa, arsimi apo e brendshnja.

Progres i mëtjeshëm është bërë në lehtësimin e ofrimit të shërbimeve publike gjatë vitit 2018. Hapja e qendrave të integruara në Shkodër, Elbasan dhe Tiranë është në proces. ***Po në kontekstin e përmirësimit të ofrimit të shërbimeve, sistemi i menaxhimit të ankesave është plotësisht funksional***, si një mekanizëm për menaxhimin e ankesave të paraqitura nga qytetarët në Qendrat e Integruara ADISA. Në Nëntor 2018 është finalizuar procesi i kolokimit të sporteleve të ADISA-s në ambientet e "One Stop Shop-it" të Bashkisë Maliq si dhe janë realizuar takime me përfaqësues të Bashkive Patos, Belsh, Malësi e Madhe, Mallakastër etj. me qëllim shtrirjen e procesit të kolokimit të sporteleve edhe pranë këtyre bashkive. Është drejt finalizimit marrëveshja ndërmjet ADISA-s dhe Bashkisë Patos dhe po vijohet me hartimin e marrëveshjeve me bashkitë e tjera.

Zhvillim pozitiv evidentohet në drejtim të zhvillimit të kapaciteteve të administratës publike ku gjatë vitit 2018 ASPA ka zhvilluar 270 kurse trajnime duke trajnuar 5554 nëpunës. Gjithashtu është organizuar procesi i vlerësimit të nevojave për trajnim në shkallë vendi, në nivel individ dhe institucioni për administratën publike dhe është ndërtuar arkiva didaktike e kurrikulës së trajnimit për 103 module.

Në drejtim të ***përmirësimit të kapaciteteve për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil dhe menaxhimit të burimeve njerëzore***, është përmirësuar dhe lehtësuar komunikimi dhe ndërveprimi midis institucioneve përmes ndërtimit të portalit unik online *administrata.al*.

Portali është një platformë komunikimi dhe raportimi e përbashkët për të gjithë administratën publike, që ju vjen në ndihmë burimeve njerëzore të institucioneve në nivel qendror dhe vendor për unifikimin e praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore. *Administrata.al* është një burim informacioni i vetëm dhe i përqendruar që siguron shkëmbim njohurish/informacioni. Kjo platformë përmban praktikën, procedurat dhe bazat ligjore për procedurat e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe do të zhvillohet më tej duke përfshirë një numër edhe më të madh praktikash e të dhënash në dispozicion të administratës dhe qytetarëve.

Në drejtim të hartimit të katalogut të përshkrimeve të punës, ka vijuar rishikimi i përshkrimeve të punës, ku gjatë gjashtë-mujorit të dytë të vitit 2018, ministritë e linjës kanë përcjellë pranë DAP

përshkrimet e punës. Bazuar në problematikat e evidentuara nga DAP, konkretisht në pjesët e misionit, qëllimit, detyrave kryesore dhe kërkesave të posacme, u realizuan takime individuale me njësitë e burimeve njerëzore të Kryeministrisë dhe ministrive e linjës për t'i orientuar saktë mbi mënyrën e hartimit të përshkrimeve të punës sipas standardeve të përcaktuara⁹.

Gjatë vitit 2018 është përmirësuar më tej procesi i rekrutimit dhe plotësimit të nevojave institucionale, me ndërmarrjen e një sërë masash në drejtim të përmirësimit të procesit të testimit, pasurimit të bankës së pyetjeve për proceset e rekrutimit në shërbimin civil, përgatitjes së një sërë materialesh orientuese për t'i ardhur në ndihmë të gjithë aplikantëve potencialë, trajnimit të anëtarëve të Komiteteve të Përhershme të Pranimi mbi metodologjinë dhe teknikat e sakta të vlerësimit të kandidatëve, bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë me qëllim informimin e kandidatëve potencialë (studentët dhe të sapodiplomuarit) lidhur me mundësitë e punësimit në administratën shtetërore, etj. Me qëllim rritjen e efikasitetit të menaxhimit të procedurave të rekrutimit si dhe paraseleksionimit të kandidatëve më të kualifikuar, në Dhjetor 2018, u miratuan ndryshime në dy Vendimet e Këshillit të Ministrave që rregullojnë procedurat e konkurimit¹⁰.

Shtrirja e Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) vazhdon të mbetet një prioritet i rëndësishëm. Gjatë vitit 2018 ka vijuar me intensitet puna për popullimin me të dhëna e sistemit si dhe janë trajnuar në bashkëpunim me ASPA punonjësit e burimeve njerëzore dhe të financës si përdorues të Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS). Vlen për t'u theksuar se gjatë 2018 është rritur ndjeshëm numri i institucioneve që **gjenerojnë pagat e punonjësve të administratës nëpërmjet HRMIS**, proces ky i cili po zbatohet në 90 institucione shtetërore.

Në drejtim të përmirësimit të procedurave administrative dhe mbikëqyrjes, vëmendje e veçantë është vijuar t'i kushtohet rishikimit të procedurave për ofrimin e shërbimeve ndaj publikut dhe thjeshtimit të tyre, duke përfshirë zgjidhje të Teknologjisë së Infomacionit dhe Komunikimit.

Zhvillime ka patur edhe sa i takon shërbimeve online që mundësojnë ofrimin e më shumë shërbimeve elektronike për qytetarët, bizneset dhe administratën. Aktualisht, portali qeveritar e-Albania ofron 591 shërbime elektronike dhe 49 sisteme shtetërore bashkëveprojnë me njëri-tjetrin për të garantuar komunikim në kohë reale mes qytetarit dhe institucioneve publike.

Përdorimi i portalit e-Albania për punonjësit e administratës publike për të marrë vërtetime dhe dokumente, krijimi i një kanali tjetër (13 e-shërbime të reja me pagesë të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve për shlyerjen e detyrimeve tatimore ndaj shtetit) që ndihmon në punën e përditshme të biznesit dhe aplikimet online për përfitim nga skemat kombëtare të mbështetjes së fermerëve, të cilat u realizuan përmes përmes modulit të portalit e-Albania nga nëpunësit e

⁹ Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 142 datë 12.03.2014 "Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura" i ndryshuar; udhëzimin nr. 01, datë 31.05.2017 "Për hartimin e përshkrimit të pozicioneve të punës në shërbimin civil".

¹⁰ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 746, datë 19.12.2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive"

autorizuar të Agjencisë së Zhvillimit Bujqësor dhe Rural janë **disa nga rrisitë e portalit e-albania¹¹ gjatë vitit 2018.**

Zhvillime pozitive ka patur edhe në vënien në zbatim të programit institucional të transparencës nga autoritetet publike sidomos në rastin e institucioneve të pavarura dhe bashkive. Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka vijuar mbikëqyrjen mbi zbatimin e Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, nëpërmjet monitorimit të elementëve të ndryshëm të ligjit si: numri i autoriteteve publike që kanë hartuar programet e transparencës, koordinatore të caktuar nga autoritetet publike, përditësimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, numri i ankesave të shqyrtuara, hetimet e kryera, seanca dëgjimore të zhvilluara si dhe vendimet e dhëna. **219** autoritete publike kanë miratuar dhe kanë bërë publik programin e transparencës; **331** autoritete publike kanë caktuar koordinator për të drejtën e informimit dhe **178** Autoritete Publike kanë publikuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve.

Me synim zbatimin korrekt të Kodit të Procedurave Administrative, janë ndërmarrë një sërë masash në pikëpamje të hartimit të materialeve orientuese për t'i ardhur në ndihmë qytetarëve. Janë hartuar disa formate standarde të lidhura drejtpërdrejtë me parashikimet e Kodit si dhe është punuar në drejtim të vlerësimit të përafrimit të ligjeve sektoriale në përputhje me këtë Kod.

Viti 2018 ishte viti i parë i zbatimit të planit të ri të veprimit 2018-2020 të Strategjisë. Nga të dhënat e raportuara dhe analiza e kryer, zbatimi është në nivel të lartë pasi 87% e aktiviteteve janë nën zbatim. Nga 15 aktivitete në total të cilat kanë patur afat përfundimi të realizimit fundin e vitit 2018, 10 prej tyre janë realizuar plotësisht dhe 5 janë në zbatim. Bazuar në ecurinë pozitive të punës në drejtim të realizimit të këtyre 5 aktiviteteve, vlerësohet se këto aktivitete janë shumë afër përfundimit të plotë.

Përgjatë dy viteve të ardhshme, puna do të fokusohet drejt arritjes së objektivave të strategjisë duke siguruar ecurinë e zbatimit të planit të aktiviteteve dhe monitorimin e vazhdueshëm të Strategjisë.

¹¹ Portali e-Albania përdoret nga punonjësit e administratës publike për të marrë vërtetime dhe dokumente të cilat gjenden si shërbime të portalit (me vule dixhitale) për plotësimin e dokumentacionit shoqëruar të shërbimit të kërkuar nga qytetari. Këto dokumente nuk i kërkohen më vetë qytetarit gjatë marrjes së një shërbimi publik.

II. Hyrje

Reforma në administratën publike në Shqipëri mbetet thelbësore në procesin e integritetit të vendit në Bashkimin Europian. Një administratë publike profesionale, e bazuar në meritokraci dhe e aftë për të ofruar shërbime cilësore ndaj publikut, është një parakusht për qeverisjen transparente dhe demokratike. Një kornizë strategjike e mirëpërcaktuar përbën themelet mbi të cilat ndërtohet zbatimi i reformës në administratën publike.

Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike, e miratuar në muajin Prill 2015, shërben si një dokument strategjik që orienton reformimin e administratës, bazuar në katër shtylla kryesore, objektiva të qarta dhe një plan veprimi me aktivitete konkrete.

Dhënia e rekomandimit të Komisionit Europian për të hapur procesin e negociatave me Shqipërinë shënon një hap të rëndësishëm përpara në procesin e integritetit europian, proces i cili kërkon një administratë profesionale dhe kapacitete njerëzore e materiale për të mundur jetësimin e politikave dhe objektivave kombëtare.

Në këtë kontekst, Strategjia udhëhiqet nga vizioni:

“Zhvillimi i një administrate publike që siguron shërbime me cilësi të lartë për qytetarët dhe bizneset në mënyrë transparente, efektive, dhe efikase, nëpërmjet përdorimit të teknologjive moderne dhe shërbimeve inovative dhe përputhet me kërkesat e integritetit europian, nëpërmjet nëpunësve civilë të paanshëm, profesionalë dhe të përgjegjshëm, pjesë e strukturave efikase”.

Zbatimi i saj mbështetet në reformat që duhet të ndërmerren në katër shtylla kryesore prioritare që synojnë përmirësimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të:

- i. Sistemit të Politikëbërjes dhe Cilësisë së Legjislacionit;
- ii. Mënyrës së Organizimit të Administratës Publike;
- iii. Shërbimit Civil dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore;
- iv. Procedurave Administrative dhe Mbikëqyrjes;

Zbatimi i Strategjisë realizohet nëpërmjet aktiviteteve të parashikuara në Planin e Aktiviteteve. Për të mbikëqyrur ecurinë e progresit të bërë për realizimin e aktiviteteve, funksionon një proces i rregullt monitorimi dhe vlerësimi. Gjatë periudhës 2015-2018 janë përgatitur 14 raporte periodike të cilat kanë në fokus monitorimin e vazhdueshëm të realizimit të aktiviteteve.

Ndërkohë arritjet e zbatimit të strategjisë dhe impakti i saj vlerësohen mbi baza vjetore nëpërmjet vlerësimit të treguesve të suksesit të përcaktuar sipas objektivave të Strategjisë. ***Ky është raporti i katërt i monitorimit vjetor të Strategjisë dhe vlerësimit të arritjeve bazuar mbi objektivat.***

Raportet e monitorimit hartohen në bashkëpunim me të gjitha institucionet e përfshira si dhe diskutohen në Grupin Tematik “Reforma për Shërbimin Civil dhe Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike” e më pas miratohen në Grupin për Menaxhimin e Integruar të Politikave për Mirëqeverisjen dhe Administratën Publike. DAP si institucion përgjegjës për

raportimin mbi zbatimin e objektivave të SNRAP është siguruar që i gjithë procesi i monitorimit dhe raportimit të jetë i cilësisë së lartë dhe që përfaqësuesit e shoqërisë civile të jenë të përfshirë në mënyrë më aktive në këtë proces. Monitorimi i zbatimit të aktiviteteve është bazuar në standardet e përcaktuara në udhëzuesin për përgatitjen, implementimin, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e Reformës së Administratës Publike dhe strategjitë sektoriale të hartuara nga SIGMA¹².

Zhvillimet dhe hapat e ndërmarrë nga Shqipëria sa i takon përbushjes së objektivave të Strategjisë Ndërsektoriale për Reformën në Administratën Publike në të katër shtyllat e saj, synojnë ***përbushjen e vizionit të kësaj Strategjie dhe forcimin e një administrate profesionale, të aftë dhe të ndërgjegjshme për rolin e saj në procesin e integritetit në Bashkimin European.***


Si një ndër pesë prioritetet e Shqipërisë për t'u përbushur me qëllim hapjen e negociatave, reforma në administratën publike kërkon angazhim serioz, këmbëngulje për të përballuar sfidat që parashtron, mbështetje të vazhdueshme por mbi të gjitha kërkon përfshirje dhe kontribut ndër-institucional.

Fokus është dhe do të vijojë të mbetet përforcimi i një administrate publike profesionale me shërbyes civilë dhe punonjës të cilët punojnë mbi vlerat të përbashkëta dhe ushtrojnë funksionet e tyre me integritet.

¹² <http://www.sigmaxweb.org/publications/SIGMA-Strategy-Toolkit-October-2018.pdf>

III. Vlerësim i përgjithshëm mbi progresin e strategjisë¹³

Plani i Veprimit 2018-2020, parashikon **zbatimin e 34 aktiviteteve bazë dhe 95 nën-aktiviteteve në total**. Deri në fund të vitit 2018, nga 95 nën-aktivitete në total, **83 prej tyre janë nën zbatim (ose 87% e totalit)** (Grafiku 1). Prej tyre, 19 nën-aktivitete vlerësohen si të realizuara plotësisht duke shënuar një rritje prej 8 nën-aktivitetesh të realizuara plotësisht krahasimisht me 6-mujorin e parë të 2018.



Ajo ç'ka vlen të përmendet është se çdo vit zbatimi i aktiviteteve të Strategjisë është në rritje dhe përpos sfidave, zbatimi ka vijuar normalisht **duke treguar një tendencë pozitive të ecurisë së SNRAP në pikëpamje të përmbushjes së objektivave**.

Me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 447 datë 26.07.2018, u miratua plani i Ri i Veprimit 2018-2020 i cili parashikon zbatimin e 34 aktiviteteve bazë dhe 95 nën-aktiviteteve. Me qëllim monitorimin e zbatimit të angazhimeve të ndërmarra përsa i përket realizimit të produkteve dhe të aktiviteteve në përgjithësi, procesi i monitorimit është kryer në nivel produkti.


Vlerësimi i nivelit dhe statusit të zbatimit të aktiviteteve të SNRAP për vitin 2018 bazohet mbi informacionin e dhënë nga çdo njësi përgjegjëse. Departamenti i Administratës Publike ka kryer vlerësimin e informacionit gjatë tre mujorit të parë të vitit 2019.

Në vijim të prezantimit të situatës si më sipër, nga një total prej 83 produktesh nën zbatim (ose 87%), **19 (ose 23%) prej tyre janë realizuar plotësisht deri në fund të vitit 2018**.

¹³ Vlerësimi i zhvillimeve për vitin 2018, në pikëpamje të arritjes së objektivave të Strategjisë realizohet nëpërmjet vlerësimit të indikatorëve (treguesve të suksesit) të parashikuar në dokumentin e Strategjisë, ndërkohë që vlerësimi i ecurisë së zbatimit të reformave të parashikuara në kuadër të strategjisë bazohet në vlerësimin e ecurisë së zbatimit të aktiviteteve të parashikuara në Planin e Veprimit.

Numri i produkteve nën zbatim për secilën nga shtyllat është:

- i. Shtylla I: “Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit” (21 produkte nga 25 në total);
- ii. Shtylla II: “Organizimi dhe Funksionimi i Administratës Publike” (16 produkte nga 18 në total);
- iii. Shtylla III: “Shërbimi civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore” (19 produkte nga 22 në total);
- iv. Shtylla IV: “Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja” (27 produkte nga 30 në total)



Grafikët më sipër paraqesin një situatë krahasuese në lidhje me statusin e vazhdueshëm të punës në fushat prioritare. Siç tregojnë grafikët, numri i produkteve “outputeve” të cilat janë nën zbatim është:

- > Nën Shtyllën I: “Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit” (21 produkte nga 25 në total, duke shënuar një rritje me 7 produkte nga raportimi i gjashtë-mujorit 2018);
- > Nën Shtyllën II, “Organizimi dhe Funksionimi i Administratës Publike” (16 produkte nga 18, duke shënuar një rritje me 2 produkte nga raporti i gjashtë-mujorit 2018);
- > Nën Shtyllën III “Shërbimi civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore” (19 produkte nga 22 në total, duke shënuar një rritje prej 2 produktesh nga raporti i gjashtë-mujorit 2018).
- > Nën Shtyllën IV “Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja” (27 produkte në zbatim nga 30, shifër kjo e njëjtë me raportin e gjashtë-mujorit 2018).

Në përgjithësi, për të katër shtyllat, përqindja e aktiviteteve në zbatim është 87%.

Në pikëpamje të përmirësimit të sistemit politikëbërës dhe cilësisë së legjislacionit¹⁴, **Shqipëria ka vijuar të ndërmarrë hapat të rëndësishëm për të zbatuar sistemin e Vlerësimit të Ndikimit Rregullator (RIA). Ky sistem i ri synon përmirësimin cilësor të procesit të zhvillimit të politikave**

¹⁴ Reformë e parashikuar nën shtyllën I

bazuar në kryerjen e analizave më të thelluara të akteve ligjore, para miratimit të tyre. Vlerësimi i Ndikimit, i cili tashmë është i detyrueshëm¹⁵, mundëson gjithashtu rritjen e transparencës dhe përmirësimin e cilësisë së hartimit të legjislacionit. Me mbështetjen e OECD/SIGMA është miratuar versioni i parë i **Metodologjisë për Vlerësimin e Ndikimit Rregullator për të vijuar** me pilotimin e zbatimit të kësaj Metodologjie. Gjatë muajit Shkurt 2018 është ngritur “Rrjeti RIA”, me përfaqësues nga Kryeministria dhe të gjitha ministratë e linjës, me synimin për të çuar përpara dhe zbatuar vlerësimin e ndikimit rregullator në Shqipëri.

Ka patur ecuri pozitive për zhvillimin e tre sistemeve të menaxhimit të informacionit: IPSIS¹⁶, AFMIS¹⁷ dhe EAMIS¹⁸ **me qëllim planifikimin dhe monitorimin e integruar të politikave strategjike dhe menaxhimin financiar/ndihmën e huaj përmes një sistemi të integruar të mirëqeverisjes.** Gjatë vitit 2018 është krijuar databaza me VKM, Udhëzime dhe akte të hartuara ndër vite për IPS nga SIGMA, e pasuruar gjithashtu me eksperiencë (ligje dhe akte nënligjore) për Planifikimin Strategjik të Integruar nga vende të ndryshme. Gjithashtu po punohet për hartimin e draftit të parë mbi IPS. Në kuadër të funksionimit të GMIP për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik dhe në zbatim të qasjes sistematike dhe sektoriale të integruar është arritur që të mobilizohen strukturat dhe bashkërendohen reformat respektive në fushën e mirëqeverisjes.

Janë plotësuar mekanizmat ligjore institucionale që sigurojnë pjesëmarrjen e publikut në konsultimin e politikave publike. Regjistri Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik (RENJK) tashmë është ngritur dhe është i aksesueshëm për publikun. Pas riorganizimit strukturor të administratës qendrore, janë përcaktuar qartë edhe përgjegjësitë institucionale sa i takon procesit të monitorimit të konsultimit publik, duke vendosur përgjegjësinë brenda aparatit të Kryeministrit. Për vitin 2018, në kuadër të procesit të konsultimit publik dhe përdorimit të regjistrit elektronik për konsultimin e akteve me të gjithë aktorët dhe palët e interesuara, rezulton se janë konsultuar 58 akte ligjore me një total vizitash prej 17,241. Gjatë këtij viti i është kushtuar vëmendje e veçantë përmirësimit të cilësisë së procesit të konsultimit publik, nëpërmjet mekanizmave që sigurojnë reflektimin në politikat publike të kontributit të qytetarëve dhe grupeve të interesit kur rezulton se pas procesit të pilotimit të metodologjisë së Vlerësimit të Ndikimit (RIA), për projektligjet e përcaktuara me Urdhër të Kryeministrit nr. 102, datë 14.06.2017, të ndryshuar. Me mbështetjen e SIGMA, në muajin Mars 2018, është finalizuar procesi i përditësimit të Metodologjisë së Vlerësimit të Ndikimit, si dhe është botuar Metodologjia Finale. Përditësimi i rradhës i Metodologjisë së Vlerësimit të Ndikimit do të bëhet në vitin 2020 duke u mbështetur në analizën e rasteve praktike të bazuara në metodologjinë aktuale.

Ecuri ka patur edhe nën Shtyllën II, e cila synon përmirësimin e mënyrës së organizimit dhe funksionimit të administratës publike **përmes një procesi rrënjësor të ri-ndërtimit të mënyrës sesi ofrohen shërbimet për qytetarët, me një përjasje gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme tek qytetari.**

¹⁵ Me qëllim zbatimin e këtij procesi të rëndësishëm, është miratuar Vendimi nr. 197 datë 11.04.2018, i cili ndryshon Vendimin nr. 584 datë 28.08.2003 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”. Nëpërmjet kësaj ndryshime, ndër të tjera, parashikohet detyrimi për kryerjen e vlerësimit të ndikimit gjatë procesit të politikëbërjes/hartimit të legjislacionit.

¹⁶ Sistemi i Planifikimit të Integruar të Menaxhimit të Informacionit

¹⁷ Sistemi i Menaxhimit Financiar

¹⁸ Sistemi i Menaxhimit të Asistencës së Huaj

Ka përfunduar vlerësimi i Procedurave Standarde Operacionale (PSO) në bashkitë e vendit dhe është hartuar një udhëzues për hartimin e Procedurave Standarde Operacionale në nivel lokal. Me qëllim zbatimin korrekt të udhëzuesit të PSO, janë zhvilluar trajnime në 61 bashkitë e vendit. Në kuadër të projektit STAR 2 është kryer procesi i arkivimit fizik të dokumentacionit në 61 bashkitë e vendit (318 Njësi Administrative) dhe 80% e arkivistëve në nivel vendi u trajnuan e u pajisën me certifikatë në bashkëpunim me ASPA.

Gjatë vitit 2018, rezulton se janë në proces ngritje dy Qendra të Integruara si dhe një Njësi Lëvizëse është në proces blerje. Gjatë kësaj periudhe, në kuadër të forcimit të mëtejshëm të ofrimit të shërbimeve publike qendrore në Shqipëri nëpërmjet njërive lëvizëse, është realizuar një studim fizibiliteti në zona të thella të 7 (shtatë) qarqeve, konkretisht Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër, Tiranë, Gjirokastrë, Korçë.

Në të gjitha institucionet e administratës shtetërore ka vijuar puna për garantimin e zbatimit rigoroz të legjislacionit për nëpunësin civil. Rol kryesor në këtë proces kanë patur Drejtoritë e Burimeve Njerëzore me qëllim ndërgjegjësimin e punonjësve për njohjen, unifikimin dhe mbikëqyrjen e të gjitha procedurave për përmirësimin e performancës së administratës publike.

Gjatë vitit 2018 ***janë hedhur hapa konkrete drejt mundësisit të gjenerimit të pagave të punonjësve të administratës nëpërmjet HRMIS***, ku vetëm gjatë kësaj periudhe janë shtuar 80 institucione të administratës shtetërore të cilat bëjnë gjenerimin e pagës nëpërmjet sistemit duke e çuar numrin total të institucioneve në 90. ***Gjithashtu, Sistemi Informatik i Manaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) është pasuruar më tej më të dhëna nga institucionet e administratës publike***, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, duke bërë të mundur që të hidhen në sistem mbi **790** institucione dhe informacion për mbi **50,000** të punësuar. Ndër të tjera, gjatë vitit 2018 DAP në bashkëpunim me ASPA kanë zhvilluar trajnime me punonjësit e institucioneve të administratës publike të cilët janë përdorues të sistemit duke trajnuar në total gjatë kësaj periudhe mbi 230 punonjës nga njësitë e burimeve njerëzore dhe financës.

Ecuri e mirë është bërë në drejtim të përmirësimit të procedurave administrative dhe mbikëqyrjes ku prioritet mbetet rishikimi i procedurave për ofrimin e shërbimeve ndaj publikut dhe thjeshtimin e tyre, duke përfshirë zgjidhje TIK në rastet kur është e mundur. Aktualisht, portali qeveritar e-Albania ofron **591** shërbime elektronike, dhe **49** sisteme shtetërore bashkëveprojnë me njëri-tjetrin për të garantuar komunikim në kohë reale mes qytetarit dhe institucioneve publike. ***Për herë të parë administrata publike bashkërendon gjenerimin e 33 dokumenteve me vulë dixhitale.***

IV. Progresi i zbatimit të reformave në kuadër të secilit prioritet


Shtylla I: Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit

Objektivat kryesore fokusohen në:


- ❖ Përmirësimin e planifikimit e koordinimit të politikave për të hartuar dokumenta strategjikë të qeverisë që i shndërrojnë prioritetet në veprime konkrete;
- ❖ Zbatimin e një sistemi transparent e gjithëpërfshirës të hartimit të ligjeve, i bazuar në politika dhe që siguron përafrimin me *acquis*;
- ❖ Ndërtimin e një sistemi monitorimi dhe vlerësimi efikas të strategjive, programeve dhe kuadrit ligjor në fuqi, të mbështetur në: (i) mbledhjen e të dhënave, nëpërmjet një procesi asnjans dhe transparent, për hartimin dhe zbatimin e strategjive, programeve dhe legjislacionit si dhe (ii) në hartimin e analizave për vlerësimin e efekteve të krijuara nga zbatimi i politikave.

Gjatë vitit 2018, nën Shtyllën 1 “Politikëbërja dhe Cilësia e Legjislacionit” kanë filluar zbatimin 21 nën-aktivitete si dhe janë realizuar plotësisht 12 nën-aktivitete të reja.

Grafiku 5. Numri i produkteve në zbatim sipas Objektivave



Grafiku 6. Statusi i realizimit të produkteve sipas Objektivave



Progresi kundrejt secilit objektiv:

Nga 8 produkte të parashikuara nën **Objektivin 1** “Politikat planifikuese dhe koordinuese të përmirësuar për të hartuar dokumenta strategjikë të qeverisë që i shndërrojnë prioritetet në veprime konkrete” pjesa më e madhe e tyre (7) kanë filluar tashmë zbatimin dhe 3 janë realizuar plotësisht deri në fund të vitit 2018.

Progres është arritur në drejtim të zhvillimit të mëtejshëm të kuadrit strategjik. Përmirësimi i planifikimit e koordinimit të politikave lidhet ngushtësisht me zbatimin e Sistemit të Planifikimit të

Integruar, përmes së cilit Qeveria synon të harmonizojë kuadrin strategjik/prioritetet strategjike me planifikimin financiar afatmesëm duke përcaktuar në terma të përgjithshëm rolin, statusin dhe hierarkinë e planifikimit strategjik.

Aktualisht, nga lista e 30 strategjive, nën NSDI II **27 strategji janë miratuar** nga ku rezultojnë: 27 dokumenta të miratuar, 2 draftime të avancuara dhe 1 draft dokument fillestar.

Lidhur me hartimin e paketës ligjore për funksionalitetin e sistemit IPSIS, me asistencën e SIGMA është krijuar një databazë me VKM, Udhëzime dhe akte të hartuara ndër vite për Sistemin e Integruar të Planifikimit (IPS), e cila është pasuruar gjithashtu me ligje dhe akte nënligjore nga vende të ndryshme si: Estonia, Letonia, Kosova, Mali i Zi. Aktualisht po punohet për hartimin e draftit të parë të aktit shqiptar mbi IPS. Paketa e plotë ligjore (VKM, Urdhra, Udhëzime dhe Manuale) do të përfundohet me vënien në punë të Sistemit IPSIS në Qershor 2019.

Progres shënohet në drejtim të përmirësimit të kapaciteteve të Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes & ministrive të linjës në drejtim të monitorimit të politikave/strategjive/planeve të veprimit/programeve zhvillimore në përputhje me metodologjitë e IPSIS & AFMIS. Ky proces ka nisur me takime ndërgjegjësimi të drejtorëve të përgjithshëm, më tej u krijua rrjeti i pikave të kontaktit për IPSIS i përbërë nga drejtues të përgjithshëm të politikave. Gjatë kësaj periudhe janë realizuar rreth 12 takime, prezantime dhe diskutime me ministrinë e linjës dhe Kryeministrinë për IPSIS.

Me miratimin e Dokumentit të Dizajnimit të Sistemit në Shkurt 2019, deri në përfundim të kontratës në Qershor 2019, do të vijohet me aktivitete të tjera të rëndësishme të testimit, vënies në punë të sistemit, përgatitjes së manualeve nga kompania, miratimit të tyre dhe përgatitjes së procedurave përkatëse për trajtimin e përdoruesve të sistemit.

Ka vijuar gjithashtu puna për përmirësimin e instrumenteve për politikën e zhvillimit dhe mirëqeverisjes në nivel qendror dhe në nivel sektori, më konkretisht për përgatitjen e një Udhërrëfyese për Objektivat e Zhvillimit të Mijëvjeçarit (*fazë paraprake si pjesë e procesit të përgatitjes së Strategjisë Kombëtare përtej 2020*). Në këtë kontekst Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes ka bashkërenduar punën me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe partnerët ndërkombëtarë (Delegacioni i Bashkimit Evropian) për rishikimin e bazës ligjore dhe kuadrit rregullator lidhur me funksionimin e GMIP-ve. Në Tetor 2018 u miratua Urdhri nr. 157 “*Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjërë sektoriale/ndërsektoriale si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizimit sektorial/ndërsektorial të integruar*”, i cili përcaktoi krijimin e 5 Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) dhe 5 Komiteteve Drejtuese Sektoriale (KDS). Gjatë vitit 2018, me qëllim mobilizimin e mekanizmit dhe vijueshmërinë lidhur me përgatitjen, rishikimin dhe monitorimin e politikave të sektorëve respektivë janë zhvilluar 6 takime të GMIP/KDS dhe 8 grupeve tematike.

Puna ka vijuar intensivisht për njoftimin formal dhe informimin më të detajuar teknik të institucioneve lidhur me mënyrën e funksionimit të mekanizmit sektorial të integruar si dhe ngritjen e strukturave përgjegjëse.

Brenda muajit nëntor është ngritur dhe funksionon Sekretariati i Përgjithshëm i Mekanizmit, i cili ka zhvilluar dy mbledhje brenda vitit 2018. Gjithashtu kanë filluar të ndërmerren veprimet ligjore për ngritjen Sekretariateve Teknike për secilën GMIP.

Indikatori 1a.	Vlera 2018
100% e kuadrit strategjik rregullator i hartuar dhe i zbatuar	80%

Në lidhje me aftësitë planifikuese dhe zbatimin e Planit Kombëtar të Integritimit Evropian, për vitin 2018 janë miratuar të gjithë dokumentat e parashikuara në PKIE dhe 80% e dokumentave të parashikuar në Planin Analitik Vjetor të Akteve duke shënuar përqindjen më të lartë në raportin planifikim-miratim.

Indikatori 1b.	Vlera 2018
“100% e strategjive dhe e cilësisë sektoriale e përfunduar” (me llogaritjen e kostos së planit të veprimit dhe grupin e indikatorëve me objektivat përkatës)	82%

Përsa i takon indikatorit 1b “100% e strategjive dhe e cilësisë sektoriale e përfunduar” për vitin 2018 ky indikator është arritur në 82%, krahasuar me 100 % në vitin 2017, 85,7% për vitin 2016 dhe 70% në vitin 2015.

Gjatë vitit 2018 është miratuar Strategjia Kombëtare e Energjisë 2015-2030, duke rritur numrin e dokumenteve të miratuara deri në 27, kundrejt 30 dokumentave në total.

Në kuadër të forcimit të qasjes sistematike dhe një sistemi të integruar të qeverisjes të fokusuar drejt qasjes funksionale, gjatë vitit 2018 është arritur dukshëm progres për finalizimin e tre sistemeve të menaxhimit të informacionit: IPSIS¹⁹, AFMIS²⁰ dhe EAMIS²¹.

Sistemi i Planifikimi të Integruar (IPS) është në fazën e automatizimit të shtyllave kryesore të tij, që konsiston në ngritjen dhe funksionimin e tre sistemeve MIS²² të cilat do të funksionojnë si një “one-stop-shop” për menaxhimin e politikave dhe financave publike nga ana e administratës shtetërore.

Zbatimi i këtyre tre sistemeve mbështet drejtpërdrejt modernizimin e administratës publike dhe zbatimin e parimeve të qeverisjes së mirë, të cilat pavarësisht natyrës komplekse janë dizenuar për të funksionuar si një sistem i vetëm (*One Single System - OSS*). Duke operuar si një i vetëm (OSS), krijohen kushtet për një qasje sistematike dhe të orientuar drejt performancës, planifikim efikas të politikave të përputhura me programet buxhetore; raportim në kohë reale dhe monitorim të rezultateve dhe performancës për treguesit kryesorë.

Objektivat madhore të sistemit/One Single System (IPSIS, AFMIS dhe EAMIS) konsistojnë në:

¹⁹ Sistemi i Planifikimit të Integruar të Menaxhimit të Informacionit

²⁰ Sistemi i Menaxhimit Financiar

²¹ Sistemi i Menaxhimit të Asistencës së Huaj

²² Sisteme të Menaxhimit të Informacionit

- i. Menaxhimin e orientuar nga Performanca & Rezultatet përmes treguesve të vlerësimit;
- ii. Rritjen e cilësisë së Mirëqeverisjes, Llogaridhënies & Transparencës;
- iii. Krijimin e një sistemi fleksibël raportimi shumë-dimensional.

Hapa të rëndësishëm institucional janë ndërmarrë në drejtim të reflektimit të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) në politikat kombëtare (“Azhenda 2030 për zhvillim të qëndrueshëm e Kombeve të Bashkuara “Të transformojmë botën tonë” dhe harmonizimi e kombëtarizimi i tyre”).

Gjatë vitit 2018 është hartuar Udhërrëfyesi për OZHQ-të i cili i ka paraprirë hartimit të Raportit mbi Harmonizimin e OZHQ me Politikat Sektoriale ekzistuese (miratuar në takimin e parë të Komitetit të OZHQ-ve), Raportimit Kombëtar Vullnetar (RKV)) i vendit i cili u prezantua nga Zëvendëskryeministri në Forumin e Nivelit të Lartë Politik, në New York (Korrik 2018).

Në këtë kuadër, gjatë vitit 2018 janë organizuar shtatë takime të Grupit Ndërinstitucional të Punës me fokus përgatitjen e RKV si dhe dy takime të Komitetit Ndërmintor për OZHQ-të. Në 3 mujin e fundit të vitit 2018 filloi puna për hartimin e dokumentit "Publikim vjetor mbi OZHQ-të" (publikimi i parë) nën drejtimin e INSTAT.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar ngritjes dhe forcimit të kapaciteteve për planifikimin strategjik. Në këtë kuadër, janë hartuar kurrikulat si dhe janë zhvilluar cikle/paketa trajnimesh nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) lidhur me hartimin dhe monitorimin e kuadrit strategjik & strategjive sektoriale/ndërsektoriale (sipas metodologjisë ekzistuese). Gjatë kësaj periudhe janë **trajnuar 152 nëpunës civil (NC)**.

Indikatori 1c.	Vlera 2018
70% e stafit të politikëbërjes të ML-së i trajnuar të paktën një herë për çështjet e planifikimit strategjik	29.57%

Ky indikator ka shënuar rënie në vitin 2018 përse i përket stafit të politikëbërjes të trajnuar duke e çuar këtë shifër afër nivelit 30% krahasimisht me 49% që ishte në vitin 2017.

Grafiku 7. Përqindja e stafit të politikëbërjes të ML-së të trajnuar të paktën një herë për çështjet e planifikimit strategjik.



Objektivi 2 "Sistem transparent e gjithëpërfshirës i hartimit të ligjeve, i bazuar në politika dhe që siguron përafrimin me *acquis*" përmban gjithsej 14 nën-aktivitete (nga të cilat 9 janë realizuar plotësisht, 4 janë nën zbatim dhe 1 nën-aktivitet parashikohet të fillojë gjatë vitit 2019).

Konsultimi publik është një nga gjashtë fushat të cilat monitorohen nga Komisioni Europian përmes SIGMA-s si dhe është një nga shtyllat e Strategjisë së Reformës së Administratës publike ku është alokuar mbështetje buxhetore (*Budget Support Performance Contract*) përmes indikatorit për konsultimin publik. Në kuadër të monitorimit të ecures së indikatorit (përmes synimeve/targeteve të përcaktuara paraprakisht) kryhen vlerësime periodike të cilat më pas raportohen pranë strukturave të Komisionit Evropian.

Gjatë vitit 2018 kanë filluar të përgatiten udhëzuesit operacionalë për ministritë e linjës për kryerjen e procesit të konsultimit publik dhe funksionimin e e-regjistrimit të konsultimit publik. Në kuadër të modelit të sistemit të integruar të qeverisjes dhe qasjes sistematike, një nga objektivat kryesore të sistemit të mirëqeverisjes lidhet me rritjen e cilësisë së llogaridhënies dhe transparencës duke patur komponent kryesor konsultimin publik.

Për këtë qëllim është hartuar databaza e plotë me kontaktet e koordinatorëve në ministritë e linjës dhe është riaktivizuar Rrjeti i Koordinatorëve të Konsultimeve Publike (RKKP). Gjatë kësaj periudhe është zhvilluar një mision i parë me ekspertët e SIGMA të cilët po asistojnë në hartimin e kuadrit metodologjik për të zhvilluar një draft të parë të metodologjisë për konsultimin publik.

Duke synuar mbarëvajtjen e procesit të konsultimeve publike në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) janë zhvilluar dy workshope të dedikuara rrjetit të koordinatorëve me qëllim njohjen me regjistrin elektronik, rëndësinë e procesit të konsultimit publik, hartimin e pipeline të akteve të planifikuara dhe të miratuara/konsultuara, etj. Gjithashtu është zhvilluar edhe një workshop me SIGMA/OECD së bashku me ministritë e linjës për të identifikuar problematikat që hasen gjatë procesit të konsultimit publik, si edhe hartimin e një metodologjie me ndihmën e kësaj ekspertize.

Nën këtë objektiv parashikohet dhe përgatitja e manualit për konsultimin publik (për publikun dhe ekspertët) për të lehtësuar pjesëmarrjen në konsultimet publike përmes përdorimit të regjistrimit të e-konsultimit. Ky aktivitet është realizuar plotësisht, ku gjatë vitit 2018 u hartua manuali i përdorimit të regjistrimit elektronik si dhe shpjegimet e hollësishme lidhur me procedurën e raportimit në bashkërendim me AKSHI-n. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018, janë zhvilluar dy workshope në bashkëpunim me AKSHI-n për të trajnuar rrjetin e koordinatorëve të konsultimit publik mbi përdorimin e regjistrimit elektronik si edhe takime të dedikuara me koordinatorët mbi përdorimin e regjistrimit elektronik dhe publikimin e akteve ligjore.

Sa i takon zbatimin të procesit të vlerësimit të ndikimit janë ndërmarrë hapat e nevojshëm për realizimin e tij. Zbatimi i këtij procesi synon të rrisë cilësinë dhe efektivitetin e hartimit të politikave/legjislacionit në Shqipëri dhe të sigurojë që ndërhyrja e qeverisë është e drejtuar aty ku është e nevojshme, duke dhënë rezultate më të mira me një kosto minimale rregullatore administrative nëpërmjet analizave *ex-ante* të vlerësimit të politikave/akteve ligjore, para miratimit

të tyre. Zbatimi i këtij procesi kontribuon gjithashtu në rritjen e transparencës dhe në hapjen e procesit të hartimit të politikave të qeverisë.

Në zbatim të Urdhrit nr. 102, datë 14.6.2017, të Kryeministrit, “Për ngritjen e grupeve të punës për pilotimin e zbatimit të metodologjisë së vlerësimit të ndikimit në disa ministri”, ndryshuar me Urdhrin nr. 194, datë 9.11.2017, nëpërmjet mbështetjes së SIGMA, ka filluar procesi i pilotimit për zbatimin e metodologjisë së Vlerësimit të Ndikimit, i cili u finalizua në Dhjetor 2018. Ky proces pilotimi u krye nga dy ministri: Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë. Ministria e Financave dhe Ekonomisë pilotoi zbatimin e metodologjisë së Vlerësimit të Ndikimit gjatë procesit të hartimit të projektligjit “Për nxitjen e punësimit”, ndërkohë që Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë pilotoi zbatimin e metodologjisë së Vlerësimit të Ndikimit gjatë hartimit të projektligjit “Për prodhimin, transportimin dhe tregtimin e biokarburantëve dhe të lëndëve të tjera djegëse të rinovueshme, për transport”.

Me qëllim koordinimin dhe zbatimin sa më efikas të procesit të vlerësimit të ndikimit edhe në ministrinë e linjës, në muajin Shkurt 2018 u krijua “Rrjeti i RIA” (vlerësimi i ndikimit). Ky rrjet në përbërjen e tij ka 3 përfaqësues nga çdo ministri, të caktuar një nga sektori i politikave, një nga sektori juridik dhe një nga sektori i financave. Rrjeti i RIA dhe procesi i vlerësimit të ndikimit në tërësi koordinohet nga Departamenti Rregullator dhe i Përpunueshmërisë në Kryeministri.

Në muajin Mars 2018 u finalizua Metodologjia e Vlerësimit të Ndikimit dhe në Prill 2018 u miratuan ndryshimet e rregullores së Këshillit të Ministrave me vendimin nr. 197, datë 11.4.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.584, datë 28.8.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, e ndryshuar”, ndryshime të cilat parashikojnë detyrimin e kryerjes së procesit të vlerësimit të ndikimit gjatë procesit të hartimit të politikave/legjislacionit.

Gjithashtu, në zbatim të vendimit nr. 584/2003, “Për miratimin e rregullores së Këshillit të Ministrave”, e ndryshuar, u miratua Urdhri nr. 6, datë 21.5.2018 i Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e projektligjeve që do t’i nënshtrohen procesit të vlerësimit të ndikimit, për vitin 2018”. Sipas këtij urdhri, parashikohen **13 (trembëdhjetë) projektligje për t’iu nënshtroar procesit të Vlerësimit të Ndikimit për vitin 2018.**

Në drejtim të forcimit të kapaciteteve brenda ministrive, me mbështetjen e OECD/SIGMA janë organizuar trajnime gjatë muajve Mars dhe Qershor 2018 me përfaqësuesit e rrjetit të RIA të çdo ministrie me qëllim përvetësimin e njohurive të nevojshme për kryerjen e procesit të Vlerësimit të Ndikimit.

Sa i përket rritjes së transparencës në botimin e legjislacionit, gjatë vitit 2018 Njësia e Programimit të Akteve Rregullatore në Kryeministri ka monitoruar procesin e publikimit të bazës ligjore të konsoliduar për secilën ministri dhe ka hartuar raportin vjetor mbi “Gjetjet e monitorimit të publikimit të legjislacionit në *website*-t e ministrive të linjës”.

Në kuadër të forcimit të masave për planifikimin e Programit të Përgjithshëm Analitik të Projektakteve për vitin 2019 (PPAP) me synim harmonizimin me PKIE-në dhe zvogëlimin e

numrit të projektligjeve të paraqitura në Kuvend, jashtë këtij programi, gjatë vitit 2018, është hartuar udhëzuesi “Për hartimin e programit të përgjithshëm analitik të projekt-akteve 2019”. Ky udhëzues përcakton rregullat, procedurat dhe afatet që duhet të ndiqen në procesin e hartimit të PPAP-së që do të paraqitet për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2019. Programi i Përgjithshëm Analitik i Projekt-akteve është përcjellë zyrtarisht pranë Kuvendit në muajin Dhjetor 2018.

Është arritur progres në plotësimin e mekanizmave ligjore insititucionale që sigurojnë pjesëmarrjen e publikut në konsultimin e politikave publike. Me implementimin e sistemit elektronik (RENjK) pas miratimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 848, datë 7.10.2015 “Për miratimin e Rregullave të Krijimit dhe Administrimit të Regjistrat Elektronik për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, është bërë i mundur përdorimi i një instrumenti të rëndësishëm për realizimin e procesit të konsultimit publik në përputhje me standardet që kërkon ligji nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”. Aktualisht rrjeti i koordinatorëve kombëtarë të konsultimit është i ngritur dhe funksional në ministritë e linjës. Aktivizimi i koordinatorëve është pasuar me trajnime të dedikuara për forcimin e kapaciteteve në lidhje me konsultimin publik.

Në kuadër të standardizimit të procedurave dhe konsolidimit të procesit është hartuar dhe vënë në dispozicion manuali i procedurave për konsultimin publik.

Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes në bashkërendim me Departamentin Rregullator dhe Përputhshmërisë, me mbështetje të SIGMA organizuan në muajin Dhjetor 2018 një trajnim me pjesëmarrës nga ministritë e linjës me qëllim përmirësimin e cilësisë së procesit i cili gjithashtu do të shërbejë për marrjen e komenteve dhe opinioneve për identifikimin e sfidave dhe vështirësive që ndeshen në zbatimin e procesit.

Për vitin 2018 janë miratuar 72 akte ligjore nga Këshilli i Ministrave (1 Strategji/ 16 Plane Veprimi dhe 55 projektligje), nga ku 73,6% e akteve kanë kaluar në proces konsultimi (forma/kanale të ndryshme konsultimi).

Indikatori 1d. Bazuar në Raportin e Forumit Ekonomik Botëror 2017-2018 mbi “Konkurueshmërinë Globale” vlera e Indeksit për Transparencën në Politikëbërje për Shqipërinë është 3.8 nga 5 targeti i synuar²³ duke pësuar një ulje me 0.9 pikë krahasimisht me vitin 2017

<i>Indikatori 1d.</i>	Vlera 2018
Përmirësimi i Indeksit të Transparencës gjatë procesit të politikëbërjes nga ana e Qeverisë, sipas Forumit Ekonomik Botëror	3.8

Indikatori 2 a. Matja e këtij indikatori është objekt i veprimtarisë së Departamentit Rregullator dhe të Përputhshmërisë dhe do të mbështetet në metodologjinë e përshkruar në pasaportën e këtij indikatori **duke filluar nga viti 2019.**

²³ Për një metodologji të detajuar ju lutem shikoni: <http://reports.weforum.org/global-competitiveness-report-2014-2015/>

Indikatori 2a.	Vlera 2018
Cilësia e analizës së vlerësimit të ndikimit dhe vlerësimi i zbatimit aktet ligjore të rëndësishme të hartuara dhe të publikuara	Duke filluar nga viti 2019

Sa i takon indikatorit mbi aktet ligjore të cilat kanë kaluar përmes një procesi të gjerë konsultimesh publike, vlera e tij për 2018 është 47.22% duke shënuar një rënie në krahasim me vitin 2017, vit në të cilin ky indikator ishte në nivelin 87%. Një trend në ulje ka shënuar dhe indikator i cilësisë së konsultimit publik i cili vlerësohet në nivelin 3.25 pikë për vitin 2018.

Indikatori 2b.	Vlera 2018
Përqindja e akteve ligjore të cilat kanë kaluar përmes një procesi të gjerë konsultimesh publike dhe provat e përfshirjes së publikut dhe palëve të interesuara në proces	47.22%

Indikatori 2c. Gjatë vitit 2018 Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë ka monitoruar ndryshimet ligjore brenda harkut kohor të 12 muajve nga miratimi projektligjit bazë apo i ndryshimeve më të fundit të tij. Të dhënat e procesit të monitorimit tregojnë se në 110 projekt-ligje, të cilat janë miratuar në vitin 2018, **9 prej tyre kanë pasur ndryshime brenda harkut kohor të 12 muajve nga miratimi i vetë ligjit apo i ndryshimit më të fundit të tij.**

Indikatori 2c.	Vlera 2018
Numri i akteve ligjore të ndryshuara brenda vitit të parë të miratimit	9

Objektivi 3 “Ndërtimi i një sistemi monitorimi dhe vlerësimi efikas të strategjive, programeve dhe kuadrit ligjor në fuqi, të mbështetur në: 1) mbledhjen e të dhënave, nëpërmjet një procesi asnjans dhe transparent për hartimin dhe zbatimin e strategjive, programeve dhe legjislacionit si dhe 2) hartimin e analizave për vlerësimin e efekteve të krijuara nga zbatimi”.

Monitorimi i zbatimit të strategjive është një proces tejet i rëndësishëm i cili siguron jo vetëm një nivel më të lartë përgjegjshmërie dhe llogaridhënie lidhur me arritjen e masave dhe objektivave të caktuara në secilën strategji të aprovuar nga qeveria por mbi të gjitha është edhe një proces që ndihmon vendimmarrësit në pasqyrimin e qartë të ecures së zbatimit të reformave të ndryshme sektoriale dhe evidentimin në kohë të problematikave të ndryshme që mund të shoqërojnë procesin e zbatimit të strategjive.

Në kuadër të transparencës dhe qeverisjes së hapur, të gjithë raportet e monitorimit dhe vlerësimit të prodhuara për dokumentat strategjike në zbatim për vitin 2018, janë vënë në dispozicion të publikut.

Raportet për efekt transparence të publikuara në mënyrë periodike dhe vjetore kanë të bëjnë me zbatimin e strategjive të mëposhtme:

1. Strategjia Sektoriale dhe Plani i Veprimit të Transportit;
2. Strategjia e Drejtësisë;
3. Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit;
4. Strategjia Kombëtare për Diasporën 2018-2024;
5. Strategjia për Pronësinë Intellektuale 2016-2020;
6. Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2015-2020.

Në drejtim të zbatimit të kuadrit të monitorimit për vitin 2018 është kryer vlerësimi i situatës së planifikimit të hartimit të dokumentave (*referuar PKIE dhe Programit Analitik - shqyrtimit të projekt-akteve 2018*) strategjike dhe realizimi në praktikë i tyre. Sipas këtij vlerësimi, referuar PKIE janë planifikuar të hartohen 14 dokumente strategjike (sipas Programit analitik - shqyrtimit të projekt-akteve 2018 janë planifikuar të hartohen 21) dhe gjatë vitit 2018 janë hartuar dhe miratuar 11 dokumenta strategjike.

Në listën prej 29 strategjish të cilat konsiderohen pjesë e SKZHI, gjatë vitit 2018 ishin planifikuar të hartoheshin 3 dokumenta, ndër të cilat është hartuar dhe miratuar vetëm Strategjia Kombëtare e Energjisë 2018 - 2030. Gjithashtu është kryer vlerësimi i situatës së hartimit të raporteve të monitorimit të strategjive, sipas të cilit rezulton se gjatë vitit 2018 janë hartuar raportet e monitorimit për 14 dokumentat strategjike si dhe është siguruar financimi dhe asistencë teknike për hartimin e raportit të Monitorimit të SKZHI II, proces i cili do të fillojë në Janar 2019.


Gjatë vitit 2018 ka nisur puna për përgatitjen e Manualit të Trajnimit për stafet e ministrive të linjës në lidhje me monitorimin e kuadrit strategjik (strategji/programme/dokumente politikash) dhe trajnimin e stafit. Manuali i Procedurave të IPSIS do të jetë gati pasi kompania të dorëzojë manualët e trajnimit në Maj 2019 dhe të adaptohen sipas kuadrit ligjor shqiptar gjatë dhe pas marrjes në dorëzim të sistemit.

Indikatori 3a.

Vlera 2018

Përqindja e raporteve të monitorimit dhe vlerësimit për strategjitë e rëndësishme të hartuara dhe të publikuara në baza vjetore. 90.9%

Grafiku 8. Përqindja e raporteve të monitorimit dhe vlerësimit për strategjitë e rëndësishme të hartuara dhe të publikuara në baza vjetore.



Indikatori 3b.	Vlera 2017
Shkalla në të cilën raportimi jep informacion mbi rezultatet e arritura (indikator i SIGMA-s)	3 ²⁴

Sipas Raportit të vlerësimit të SIGMA “një sërë dokumentash dhe raportesh të hartuara nga administrata qendrore dhe institucionet e pavaruara nuk publikohen në faqet e internetit si dhe nuk ndiqet një standard i njëjtë për hartimin e tyre”. Krahasimisht me vitin 2015 nuk ka asnjë ndryshim sa i takon vlerës së këtij indikatori, ndërsa sa i takon vitit 2018, SIGMA nuk ka bërë një vlerësim të këtij indikatori.

Indikatori 3c.	Vlera 2018
Numri i konsultimeve publike/prezantimeve të organizuara për të diskutuar raportet e monitorimit dhe vlerësimit.	11

Krahasuar me vitin 2015 që ka qenë edhe viti bazë, treguesi ka pësuar rritje me 1 pikë. Gjatë vitit 2018 janë hartuar dhe miratuar pas një procesi konsultimi 11 raporte monitorimi.

²⁴ Shih: Raporti i Vlerësimit “Parimet e Administratës Publike” fq 24


Shtylla II: Organizimi dhe Funksionimi i Administratës Publike

Objektivat e planifikuara në kuadër të Shtyllës II synojnë:


- ❖ *Fuqizimin e strukturave të administratës publike me qëllim përmirësimin e ofrimit të shërbimeve ndaj publikut.*
- ❖ *Ofrimin e shërbimeve publike të përmirësuara, të aksesueshme dhe të integruara duke reduktuar mundësitë për korrupsion dhe forcimin etikës në ofrimin e shërbimeve publike.*

Kjo shtyllë përbëhet nga 18 nën-aktivitete, 16 prej të cilave kanë filluar të zbatohen dhe ku 2 prej tyre janë realizuar plotësisht deri në 2018 (grafiku 10).

Grafiku 9. Numri i nën-aktiviteteve në zbatim sipas Objektivave



Grafiku 10. Statusi i realizimit të nën-aktiviteteve sipas Objektivave



Progresi kundrejt secilit objektivi

Në Objektivin 4 "Fuqizimi i strukturave të administratës publike për të përmirësuar ofrimin e shërbimeve për publikun", kanë nisur të zbatohen 7 nën-aktivitete të parashikuara nën këtë objektivi si dhe janë realizuar plotësisht 2 prej tyre.

Në kuadër të reformës strukturore të institucioneve të varësisë, me urdhrin nr. 59 datë 26.03.2018 të Kryeministrit u ngritën (i) struktura udhëheqëse²⁵ (ii) Komiteti drejtues²⁶; (iii) Grupi i menaxhimit²⁷; (iv) Grupi Qendror i Punës²⁸ (v) Grupet Teknike të Punës pranë ministrive²⁹.

²⁵ Struktura udhëheqëse përbëhet nga nga Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, Departamenti Rregullator dhe i Përputhshmërisë dhe Departamenti i Burimeve, Transparencës dhe Mirëadministrimit në Kryeministri).

²⁶ Komiteti Drejtues kryesohet nga Zëvendëskryeministri dhe përbëhet nga ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes, zëvendësmministri i Financave, zëvendësmministri i Drejtësisë, këshilltari i Kryeministrit për çështjet e sigurisë, drejtori i Departamentit të Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes, drejtori i Departamentit Rregullator dhe i Përputhshmërisë, drejtori i Departamentit të Burimeve, Transparencës dhe Mirëadministrimit dhe drejtori i Departamentit të Administratës Publike

²⁷ Grupi i menaxhimit kryesohet nga Drejtori i Departamentit të Administratës Publike dhe ka në përbërje të tij ekipet e menaxhimit

²⁸ Grupi qendror i punës përbëhet nga drejtori i Drejtorisë së Politikave dhe Zhvillimit të Institucioneve dhe Pagave, në Departamentin e Administratës Publike, ekspertë të fushës së organizimit të institucioneve në Departamentin e Administratës Publike dhe ekspertë të jashtëm

Komiteti drejtues i reformës strukturore të institucioneve të varësisë ka miratuar dokumentin e përgjithshëm të tipologjisë së institucioneve të varësisë. Bazuar në vendimet e këtij Komiteti si dhe në metodologjinë e SIGMA, u përcaktuan dy sisteme tek të cilat do të pilotohej tipologjia e re e institucioneve e konkretisht:

> **Sistemi i shëndetësisë**

Për këtë sistem, gjatë vitit 2018:

- U miratua nga Komiteti Drejtues modeli i ri i organizimit të institucioneve të sistemit të shëndetësisë që lidhen me shëndetin publik.
U miratua nga Këshilli i Ministrave vendimi nr. 419, datë 04.07.2018, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor”. Me miratimin e këtij vendimi, 36 drejtoritë e shëndetit publik, 413 qendra shëndetësore, 36 njësi spitalore, më parë në varësi të drejtpërdrejtë të ministrit, u riorganizuan në një institucion të vetëm, *(i cili ka në përbërje drejtorinë qendrore, 4 drejtori rajonale të cilat mbikqyrin zyrat vendore dhe qendrat shëndetësore dhe spitalet)*. U miratua nga Kryeministri struktura dhe organika e operatorit në nivel qendror dhe rajonal, si dhe nga ministri përgjegjës për shëndetësinë struktura dhe organika e zyrave vendore.
- U hartua projektstruktura e re Institutit të Shëndetit Publik, i cili do të luajë rolin e autoritetit për këtë sistem.
- U hartua projektvendimi i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Sistemit Shëndetësor”, i cili është në fazën e diskutimeve. Si rezultat kemi riorganizimin e 3 institucioneve, Qendrës Kombëtare të Cilësisë, Sigurisë dhe Akreditimit, Qendrës Kombëtare të Edukimit në Vazhdim dhe Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, në një institucion të vetëm.

> **Sistemi i arsimit**

Për këtë sistem, gjatë vitit 2018:

- U miratua nga Komiteti Drejtues modeli i ri i organizimit të institucioneve të sistemit të arsimit që lidhen me arsimin parauniversitar.
- U miratuan ndryshimet në ligjin e arsimit parauniversitar që i hapën rrugën riorganizimit të institucioneve të arsimit parauniversitar.
- U hartua projektvendimi i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”, në bazë të të cilit realizohet riorganizimi i 13 Drejtorive Arsimore Rajonale dhe 25 Zyrave Arsimore, më parë në varësi direkte të ministrit, në një institucion të vetëm, i cili do të ketë në përbërje drejtorinë qendrore, 4 drejtori rajonale të cilat do të kenë nën mbikqyrje zyrat vendore dhe institucionet e arsimit parauniversitar.

²⁹ Grupet Teknike të punës pranë ministrave përbëhen nga zëvendësmministri i fushës, drejtori/përgjegjësi i sektorit të programeve të zhvillimit/projekteve, drejtori/përgjegjës i programimit, standardizimit dhe harmonizimit të kuadrit rregullator, drejtori/përgjegjësi i buxhetit dhe menaxhimit financiar dhe ekspertë të fushës

- U hartua projektvendimi i Këshillit të Ministrave “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar”, në bazë të të cilit realizohet riorganizimi i 2 institucioneve, Institutit të Zhvillimit të Arsimit dhe Inspektoriatit Shtetëror të Arsimit, në një institucion të vetëm.
- U miratua vendimi nr. 441, datë 18.07.2018, i Këshillit të Ministrave që realizon kalimin e varësisë së Klubit Shumësportësh “Partizani” dhe Klubit Sportiv “Studenti”, nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, tek Bashkia e Tiranës

Përveç dy sistemeve si më sipër, gjatë vitit 2018, u realizuan edhe disa ndryshime në organizimin e institucioneve të varësisë, si fazë e parë, për disa sisteme të tjera, e konkretisht:

➤ **Sistemi i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**

Për këtë sistem, gjatë vitit 2018:

- U miratua vendimi nr. 146, datë 13/03/2018, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencive rajonale të shërbimit veterinar dhe mbrojtjes së bimëve” dhe vendimi nr. 147, datë 13/03/2018, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e agjencive rajonale të ekstensionit bujqësor”. Si rezultat u realizua riorganizimi i 13 drejtorive rajonale të bujqësisë, në gjithsej 8 agjenci rajonale. Për këto agjenci rajonale janë miratuar strukturat dhe organikat përkatëse.

➤ **Sistemi i Financave dhe Ekonomisë**

Për këtë sistem, gjatë vitit 2018:

- U miratua vendimi nr. 298, datë 23/05/2018, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit”. Si rezultat u realizua riorganizimi i 36 degëve të thesarit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit më parë pjesë e aparatit të ministrisë, në një institucion të vetëm në varësi të ministrit përgjegjës për financat. Për këtë drejtori është miratuar struktura dhe organika.
- U miratua vendimi nr. 299, datë 23/05/2018, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Financimeve dhe Kontraktimeve për Fondet e BE-së, BB-së dhe Donatorëve të Tjerë”, nëpërmjet të cilit u realizua shkëputja e kësaj drejtorie nga aparati i ministrisë. Për këtë drejtori është miratuar struktura dhe organika.

➤ **Sistemi i Ministrisë së Brendshme**

Për këtë sistem, gjatë vitit 2018:

- U miratua vendimi nr. 81, datë 14/02/2018, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Blerjeve të Përqëndruara”, nëpërmjet të cilit u realizua shkëputja nga aparati i Ministrisë së Brendshme, i Drejtorisë së Përgjithshme të Prokurimeve të Përqëndruara. Për këtë drejtori është miratuar struktura dhe organika.

> **Sistemi i Kryeministrit (menaxhimi i burimeve ujore)**

Për këtë sistem, gjatë vitit 2018:

- U miratua vendimi nr. 221, datë 26.04.2018, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore”. Si rezultat kemi riorganizimin në një agjenci të vetme të 9 njësive organizative dhe institucioneve, si vijon:
 - 6 agjencitë e baseneve, më parë në varësi direkte të Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
 - Drejtoria e Politikave të Burimeve Ujore në aparatën e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
 - Ish - Inspektoriati Shtetëror i Ujrave, duke shkëputur prej tij funksionin kontrollues të zbatimit të lejeve në nivel baseni ujor;
 - Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit.
- U miratua nga Kryeministri struktura dhe organika e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore.

Gjithashtu, grupi i punës i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit dhe Grupi Qendror i Punës kanë përgatitur një draft të parë të modelit të riorganizimit të institucioneve të varësisë së kësaj ministrie.

Me qëllim fuqizimin e strukturave administrative, AMMV në bashkëpunim me projektin STAR2, ka punuar gjatë vitit 2018 për adoptimin e Procedurave Standarde Operacionale (PSO). Pas vlerësimit paraprak mbi nevojat për përmirësim të PSO-ve në bashkitë e vendit, u hartuan kurrikulat e trajnimit mbi Kodin e Procedurave Administrative (KPA) dhe adoptimin e Procedurave Standarde Operacionale në nivel lokal të cilat u certifikuan nga ASPA. Bazuar në këto kurrikula, u krye një cikël i plotë trajnimesh që përfshinë 14 sesione dy ditore mbi KPA dhe PSO. Rreth 195 zyrtarë vendorë më pjesëmarrje pothuajse nga të gjithë bashkitë (57 nga 61), morën pjesë në këto trajnime.

Figura 1. Trajnimi i zhvilluar mbi Kodin e Procedurave Administrative



Pas fillimit të punës në vitin 2017, për zbatimin rigoroz të arkivimit fizik të dokumentacionit në nivel lokal, gjatë fillimit të 2018 i është kushtuar vëmendje trajnimit të punonjësve të arkivave dhe protokollit në bashkëpunim me ASPA.

Gjatë vitit 2018, nëpërmjet asistencës së projektit STAR2 filloi zbatimi i aktiviteteve të dedikuara për përfshirjen dhe konsultimin e publikut në nivel lokal. Pas vlerësimit dhe identifikimit të praktikave të mira mbi përfshirjen dhe konsultimin e publikut nga bashkitë, u hartua një manual udhëzues për bashkitë.

Indikatori 4a.	Vlera 2017
Shkalla në të cilën strukturat e ministrive dhe institucionet e tjera janë racionale dhe koherente (indikatori i SIGMA-s)	2 ³⁰

Ky tregues nuk ka pësuar ndryshim, pasi i referohet vlerësimit të OECD/SIGMA në fillimet e vitit 2017 dhe mbulon periudhën e vlerësimit 2015-2016, Sa i takon vitit 2018, SIGMA nuk ka bërë një vlerësim të këtij indikatori.

Në Objektivin 5 "Shërbime publike të përmirësuara, të aksesueshme dhe të integruara duke reduktuar mundësitë për korrupsion dhe forcimin e etikës në ofrimin e shërbimeve publike", janë realizuar 9 nga 11 produktet e parashikuara. Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018, ADISA dhe AMVV kanë vijuar punën për realizimin e objektivave të përcaktuara.

Gjatë vitit 2018, ka vijuar puna në drejtim të mirëadministrimit dhe funksionimit të qendrave të ngritura të shërbimeve të integruara me një ndalesë në Tiranë, Kavajë, Krujë, Fier, Gjirokastrë si dhe në zyrat me një ndalesë në 14 bashki, (krahasimisht me 11 bashki që ishin në vitin 2017): Shkodër, Lezhë, Durrës, Elbasan, Korçë, Vau Dejës, Mat, Klos, Sarandë, Berat dhe Fier. Gjithashtu janë në proces ngritje dy qendra të Integruara në Shkodër dhe Tiranë. Përsa i përket ngritjes së qendrës së integruar në ambientet e katit përdhe të godinës "Ish Hoteli i Oficerave" Tiranë, është hartuar projektvendimi për kalimin e këtyre ambienteve në administrim të ADISA-s. Aktualisht ky proces është në fazë negocimi me QKB në administrim të të cilës janë ambientet e sipërcituara. Gjithashtu ka vijuar puna për evidentimin e ambienteve të përshtatshme për ngritjen e një Qendre të Integruar në Elbasan.

Në lidhje me kolokimin e ADISA nëpër bashki, është finalizuar procesi i kolokimit më Nëntor 2018, të sporteleve të ADISA-s në ambientet e "One Stop Shop-it" të Bashkisë Maliq.

Figura 2. Inaugurimi i Sporteleve të kolokuara për ofrimin e shërbimit në Bashkinë Maliq



³⁰ Shih OECD/SIGMA Raporti Vlerësimit 2017 "Parimet e Administratës Publike" fq. 89-90

Gjatë kësaj periudhe janë realizuar takime me përfaqësues të Bashkive Patos, Belsh, Malësi e Madhe, Mallakastër etj. me qëllim shtrirjen e procesit të kolokimit të sporteleve edhe pranë këtyre bashkive. Është drejt finalizimit marrëveshja ndërmjet ADISA-s dhe Bashkisë Patos e cila parashikon ofrimin e shërbimeve publike nga ADISA në ambientet e kësaj bashkie. Lidhur me bashkitë e tjera aktualisht po vijohet me hartimin e marrëveshjeve sipas dakordësisë së palëve.

Me qëllim forcimin e mëtejshëm të ofrimit të shërbimeve publike qendrore në Shqipëri nëpërmjet njësive lëvizëse, është realizuar një studim fizibiliteti në zonat e thella në 7 qarqeve, konkretisht Shkodër, Lezhë, Kukës, Dibër, Tiranë, Gjirokastrë, Korçë. Në kuadër të zhvillimit të procedurës së blerjes së njësive lëvizëse, stafi i ADISA në bashkëpunim edhe me UNDP rishikoi edhe njëherë specifikimet teknike duke shtuar elementë të rinj, të cilët nuk kanë qenë të parashikuar më parë. Në muajin dhjetor është bërë shpallja e procedurës nga UNDP dhe gjatë muajit janar pritët shpallja e fituesit për të vijuar më tej me zbatimin e këtij projekti.

Në kuadër të krijimit të një modeli të ri për ofrimin e shërbimeve publike, ka vazhduar funksionimi i Qendrave të Integruara ADISA Krujë, Fier, Gjirokastrë dhe Kavajë ku ofrohen përkatësisht:

- 1) **Qendra e Integruar ADISA Krujë - 233 shërbime³¹ të 6 institucioneve në 15 sportele pritëse**, përkatësisht FSDKSH, ZRPP, ISSH, DPGJC, DPT dhe QKB, për rreth 59,814 qytetarë dhe biznese (shërbime të regjistrimit të pasurisë, sigurimet shoqërore, karta e shëndetit, regjistrimi i biznesit, gjendja civile dhe tatimet). Gjatë vitit 2018, totali i aplikimeve të kryera në sportelet pritëse është **33,909 aplikime**, ndërsa **totali i ankesave** për të njëjtën periudhë është 7.
- 2) **Qendrën e Integruar ADISA Fier - 343 shërbime³² të 8 institucioneve të nivelit qendror dhe vendor në 23 sportele pritëse**, përkatësisht FSDKSH, ZRPP, ISSH, DPT, QKB, SHKP (deri në Qershor 2018), Taksa Vendore (deri në Korrik 2018), Drejtoria e Regjistrimit të Tokave Bujqësore dhe ALUIZNI (pilotim shërbimesh, i cili filloi në Shtator 2018) për rreth 120,655 qytetarë dhe biznese (shërbime të regjistrimit të pasurisë, sigurimet shoqërore, karta e shëndetit, regjistrimi i biznesit, shërbimet e punësimit, tatimet dhe taksat vendore, regjistrimi i tokave bujqësore). Në periudhën Janar – Dhjetor 2018, totali i aplikimeve të kryera në sportelet pritëse është **49,677 aplikime** dhe numri i ankesave të depozituara në sportelin e ankesave është **1,539 ankesa**.
- 3) **Qendra e Integruar ADISA Gjirokastrë - 338 shërbime të 6 institucioneve publike në 22 sportele pritëse**, përkatësisht FSDKSH, ZRPP, ISSH, DPGJC, DPT dhe QKB, për rreth 28,673 qytetarë dhe biznese (shërbime të regjistrimit të pasurisë, sigurimet shoqërore, karta e shëndetit, regjistrimi i biznesit, gjendja civile dhe tatimet). Në Qendrën e Integruar Gjirokastrë, ALEAT ofron shërbime mbështetëse për 2 shërbime të DPGJC, përkatësisht *aplikimi për letërnjoftim elektronik dhe pasaportë biometrike*. Gjatë vitit 2018,


³¹ Në Qendrën e Integruar në Krujë ofrohen 233 shërbime, përkatësisht: 51 shërbime ZRPP, 67 shërbime ISSH, 1 shërbim FSDKSH, 64 shërbime QKB, 22 shërbime DPGJC dhe 28 shërbime DPT.

³² Në Qendrën e Integruar në Fier ofrohen 343 shërbime, përkatësisht: 51 shërbime ZRPP, 64 shërbime ISSH, 1 shërbim FSDKSH, 169 shërbime QKB, 23 shërbime SHKP, 28 shërbime DPT dhe 8 shërbime vendore.

totali i aplikimeve të kryera në sportelet pritëse është **35,862 aplikime**. Numri i ankesave të depozituara në sportelin e ankesave është **124 ankesa**.

- 4) **Qendra e Integruar ADISA Kavajë- 233 shërbime³³ të 6 institucioneve** në 17 sportele pritëse, përkatësisht FSDKSH, ZRPP, ISSH, DPGJC, DPT dhe QKB, për rreth 40,094 qytetarë dhe biznese (shërbime të regjistrimit të pasurisë, sigurimet shoqërore, karta e shëndetit, regjistrimi i biznesit, gjendja civile dhe tatimet). Gjatë vitit 2018, totali i aplikimeve të kryera në sportelet pritëse është **43,539 aplikime**, ndërsa **totali i ankesave** për të njëjtën periudhë është **430**.

Në grafikët e mëposhtëm tregohet numri i aplikimeve të kryera dhe kërkesave për informacion nga qytetarët të depozituara në sportelet pritëse ADISA në ZVRPP Tiranë dhe në Qendrat e Integruara për ofrimin e shërbimit në Kavajë, Krujë, Fier dhe Gjirokastrë:



Në kuadër të ndarjes së ofrimit të shërbimit midis zyrave pritëse dhe atyre përgjegjëse (Front Office-Back Office), si dhe ngritjes së Qendrave të Integruara, janë marrë në administrim 9 sportele: 2 FSDKSH (Gjirokastrë dhe Shkodër), 6 ISSH (Tiranë, Kavajë, Krujë, Fier, Gjirokastrë, Shkodër) dhe 1 ZVRPP (Shkodër).

Sistemi i menaxhimit të ankesave është një risi dhe një mekanizëm me anë të të cilit qytetarët mund të shprehin pakënaqësitë e tyre në lidhje me shërbimet e ofruara nga institucionet që ofrojnë shërbimet në sportelet pritëse ADISA, si: ZRPP, ISSH, FSDKSH, DPGJC, DPT etj dhe/ose në lidhje me asistentët e shërbimit nën varësi të ADISA. Me anë të këtij sistemi bëhet i mundur regjistrimi dhe menaxhimi i ankesave të paraqitura nga qytetarët në Qendrat e Integruara ADISA. Me hapjen e tre qendrave të Integruara në Krujë, Fier dhe Gjirokastrë, u bë i mundur që nëpërmjet këtij sistemi të ruhen të gjitha detajet kryesore të një ankesë, për të gjitha institucionet të cilat janë pjesë e këtyre Qendrave. Gjatë vitit 2018 janë depozituar **3,666 ankesa** për ZVRPP

³³ Në Qendrën e Integruar në Kavajë ofrohen 233 shërbime, përkatësisht: 51 shërbime ZRPP, 67 shërbime ISSH, 1 shërbim FSDKSH, 64 shërbime QKB, 22 shërbime DPGJC dhe 28 shërbime DPT.

Tiranë, **430** ankesa për institucionet në Qendrën e Integruar Kavajë, **7** ankesa për institucionet në Qendrën e Integruar Krujë, **1539** ankesa për institucionet në Qendrën e Integruar Fier dhe **124** ankesa për institucionet në Qendrën e Integruar Gjirokastrë.

Më poshtë paraqitja grafike e ankesave të depozituara në sportelin e ankesave për institucionet në Front Office ADISA ZVRPP Tiranë dhe në Qendrat e Integruara ADISA:

Grafiku 13. Numri i ankesave të depozituara në sportelet pritëse ADISA



Në kuadër të projektit “Mbështetje për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike me në qendër Qytetarin - IPSD”, ka vijuar puna për trajnimin lidhur me Manualin Operacional të kanaleve të Ofritit të Shërbimeve të Integruara. Gjithashtu, gjatë kësaj periudhe janë miratuar: VKM nr. 624 datë 26.10.2018 "Për miratimin e manualit për standardizimin e ngritjes dhe të funksionimit të sportelit të shërbimit publik" dhe VKM nr. 625, datë 26.10.2018 "Për miratimin e manualit të etikës në ofrimin e shërbimeve publike në sportel".

Zhvillimi i kapaciteteve institucionale të ADISA-s dhe institucioneve qendrore për rritjen e cilësisë së ofritit të shërbimeve **ka pasur ecuri pozitive** ku gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2018 janë organizuar trajnime në bashkëpunim me ASPA për punonjës të Agjencisë së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara dhe rezultojnë 134 punonjës të trajnuar dhe 21 trajnime të zhvilluara. Në lidhje me trajnimin e stafit të institucioneve qendrore gjatë 2018 janë trajnuar në bashkëpunim me ASPA 1260 punonjës dhe janë zhvilluar 56 trajnime. Konkretisht janë zhvilluar 22 seanca trajnimi për punonjësit e Front Office në 14 institucione dhe puna është në progres për zhvillimin e trajnimeve të tjera të planifikuara si dhe për dizajnimin e fushatës së komunikimit të ADISA për përmirësimin e ofritit të shërbimeve. Me qëllim përfitimi të eksperiencave dhe praktikave më të mira sa i takon ofritit të shërbimeve, gjatë vitit 2018 janë realizuar 2 vizita studimore: një në Republikën e Koresë së Jugut dhe një në Portugali. Gjithashtu, janë zhvilluar trajnimet si vijon: trajnim 3 ditor mbi menaxhimin e ndryshimeve, trajnim 2 ditor për kujdesin ndaj klientit dhe aftësitë e komunikimit, trajnim 3 ditor Trajnimi i Trajnerëve (TOT) për kujdesin ndaj klientit dhe aftësitë komunikuese, workshopi mbi Manualin Operacional si dhe Trajnimi TOT mbi Manualin Operacional.

Indikatori 5a.

Vlera 2018

Numri i shërbimeve të qeverisë qendrore me ndërveprim të përmirësuar në zyrat e pritjes 367



Arritjet kundrejt nivelit të synuar për vitin 2018³⁴ janë tejkaluar në nivelin 141 %. Në total, në sportelet pritëse në ZVRPP Tiranë dhe në Qendrat e Integruara në Kavajë, Krujë, Fier, Gjirokastrë dhe në Bashkinë Maliq ofrohen 367 shërbime të 10 institucioneve qendrore dhe vendore.

Indikatori 5b.

Vlera 2018

Numri i zyrave me një ndalesë të ngritura në njësitë e qeverisjes vendore 23% e bashkive

Në vijim të punës së nisur në vitin 2017 nëpërmjet asistencës së projektit STAR2, gjatë vitit 2018 përfundoi zhvillimi i sistemit me një ndalesë, i cili hapi rrugë për shpërndarjen e modelit në



bashkitë e përzgjedhura si pilot. Modeli i “sporteleve me një ndalesë” për shërbimet administrative në nivel vendor përfshin workflow për rreth 60 shërbime administrative. Gjatë vitit 2018, tre bashki pilot përfunduan dhe finalizuan punën për sistemin dhe filluan zbatimin e “sporteleve me një ndalesë”. Gjithashtu

janë përgatitur dhe validuar kurrikula dhe materiale trajnimi për këtë proces.

³⁴ Niveli i synuar për vitin 2018 është 150 (referuar Pasaportës së Indikatorëve, fq. 15).


Shtylla III Shërbimi civil: Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Objektivat e parashikuara synojnë:


- ❖ *Përmirësimin e kapaciteteve për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil dhe procedura të lehtësuara për zbatim;*
- ❖ *Organizimin e sistemit të pagave në shërbimin civil duke u bazuar në vlerësimin e vendit të punës, të arritjeve vjetore të nëpunësve civilë dhe rezultateve në trajnimet e detyrueshme;*

Nën këtë shtyllë kanë filluar të zbatohen 19 aktivitete nga 22 në total. Ndër 19 nën-aktiviteteve në zbatim, 1 prej tyre është realizuar plotësisht.

Grafiku 14. Numri i produkteve në zbatim sipas Objektivave



Grafiku 15. Statusi i realizimit të produkteve sipas Objektivave



Progresi kundrejt secilit objektiv

Objektivi 6: Kapacitete të përmirësuara për zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil dhe procedura të lehtësuara për zbatim. Për këtë objektiv, nga 19 aktivitete në total, 18 prej tyre janë nën zbatim.

Gjatë vitit 2018 ka vijuar puna intensive për forcimin e kapaciteteve të DAP dhe strukturave të menaxhimit të burimeve njerëzore për të udhëhequr strategjikisht reformën e shërbimit civil. Një nga masat e ndërmarra në këtë drejtim është organizimi i takimeve të Rrjetit Profesional të Burimeve Njerëzore, përbërë nga përfaqësues të njësisë të menaxhimit të burimeve njerëzore në ministri dhe institucionet e varësisë. Gjatë këtyre takimeve u krye një analizë e punës së përbashkët dhe u diskutuan problemet e ndeshura dhe sfidat e së ardhmes. Takime të tilla do të vijojnë të organizohen periodikisht duke qenë një mundësi shumë e mirë për të ndarë praktikatat e

suksesshme dhe për të siguruar kuptimin dhe zbatimin uniform të proceseve të punës në kuadër të menaxhimit të burimeve njerëzore. Në muajin tetor në ambientet e Departamentit të Administratës Publike u zhvillua një takim me drejtorët e burimeve njerëzore në ministri ku u shpjegua përmbajtja e portalit *administrata.al*, një portal i integruar ndërveprimi dhe raportimi, *administrata.al*, dedikuar posacërisht administratës publike. Në këtë takim u shpjegua gjithashtu mënyra e raportimit të informacionit që duhet të kryejnë institucionet qendrore dhe vendore.

Administrata.al është një platformë komunikimi dhe ndërveprimi e përqendruar që vë në dispozicion praktika, udhëzime dhe bazën ligjore si dhe siguron shkëmbim njohurish/informacioni duke sjellë unifikimin e procedurave të menaxhimit të burimeve njerëzore. Gjatë takimit u theksua rëndësia e bashkëpunimit mes institucioneve qendrore, institucioneve të varësisë, degëve rajonale dhe njësisë vendore për sigurimin e raportimit mujor në mënyrë cilësore dhe në kohë reale. Portali përmban informacion mbi praktikat institucionale, bazën ligjore, shpalljen e vendeve vakante në shërbimin civil, masat disiplinore, vendimet gjyqësore etj.

Pa dyshim, ndër mekanizmat më efektivë në forcimin e kapaciteteve mbetet trajnimi i nëpunësve. Në këtë drejtim, gjatë vitit 2018 nëpunësit e Departamentit të Administratës Publike kanë marrë pjesë në disa trajnime si: trajnimi për “Sfidat e Integritetit në Rekrutimin dhe Përzgjedhjen në Shërbimin Civil” organizuar nga Shkolla Rajonale e Administratës Publike (ReSPA), trajnimi për “Prezantimin me Administratën Kineze” organizuar nga Qeveria Kineze, trajnimi për “Aksesimin e Gjykatës së Bashkimit Evropian në mënyrë të suksesshme” organizuar nga Instituti Evropian i Administratës Publike (EIPA), trajnimin për “Coaching” organizuar nga ReSPA, trajnimin për “Coaching mbi HRMIS” organizuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, trajnimin për “European Youth Event” organizuar nga Paramenti Evropian, trajnim për “Train the Trainer Programme” organizuar nga Instituti i Administratës Publike (IPA Irlandë), trajnimi për “Programme in EU Law and Economics” organizuar nga Riga Graduate School of Law, trajnimin për “Zhvillimin dhe Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në sektorin publik” organizuar nga Agjencia Koreane për Bashkëpunimin Ndërkombëtar (KOICA).

Rishikimi i përshkrimeve të punës dhe hartimi i katalogut të përshkrimeve të punës është një ndër komponentët e rëndësishëm të cilët do të realizohen nëpërmjet zbatimit të projektit IPA 2014 “Zbatimi i Reformës së Shërbimit Civil në Administratën Publike” i cili ka filluar në Tetor 2018 dhe do të zgjasë deri në 2021. DAP ka filluar punën përgatitore për hartimin e katalogut të përshkrimeve të punës duke mbledhur nga Kryeministria dhe Ministrinë e Linjës përshkrimet e punës. Me përcjelljen e tyre pranë DAP, rezultoi se më shumë se 50% e përshkrimeve të punës kishin probleme në ndarjet si: *misioni, qëllimi, detyrat kryesore, përgjegjësitë kryesore dhe kërkesat e posaçme*. Me qëllim përmirësimit të cilësisë së përshkrimeve të punës dhe ndjekjes me rigorozitet të standardeve të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimin e DAP dedikuar përshkrimeve të punës, u realizuan takime individuale me njësitë e burimeve njerëzore të Kryeministrisë dhe Ministrive të linjës për mënyrën se si duhen hartuar përshkrimet e punës.

Kryerja e vlerësimeve 'ad-hoc' (sipas rasteve) për të marrë opinionin e aplikantëve mbi procesin e rekrutimit dhe marrja e masave për të adresuar çështjet që dalin nga vlerësimi ka vijuar me ritme pozitive. Për herë të parë gjatë vitit 2018, DAP, duke vlerësuar rëndësinë e opinionit të kandidatëve që marrin pjesë në procedurat e konkurimit, vendosi të ndërmarrë një iniciativë të re e cila nxit dhënien e opinionit. Marrja e opinionit nga aplikantët mbi procesin e rekrutimit kryhet pikë së pari nga vetë komisionet e vlerësimit të cilët në përfundim të fazës së intervistës së strukturuar shpesh i drejtojnë pyetje kandidatëve (zgjedhja e tyre është rastësore) në lidhje me problematikën e ndeshur gjatë procedurës së konkurimit ose sugjerimet që mund të kenë ata. Forma të tjera të sigurimit të këtij lloj informacioni janë edhe ankesat e përcjella nga kandidatët pjesëmarrës në konkurim ose ankesat/kërkesat e dërguara elektronikisht përmes kanaleve të komunikimit si: adresa e dedikuar e emailit info@dap.gov.al, numri i telefonit në dispozicion, llogaria e Departamentit të Administratës Publike në rrjetin social facebook apo Platforma e Bashkëqeverisjes. Në vijim planikohet të organizohen edhe anketime të kandidatëve online dhe në përfundim të testimit me shkrim. Në këtë mënyrë do të jetë i mundur siguri i opinionëve të strukturuar dhe prioritarizimi i problemeve për t'u adresuar.

Me qëllim garantimin e transparencës, të drejtës për informim dhe për një vlerësim sa më objektiv, DAP ka ftuar kandidatët për t'u njohur me çelësin e përgjigjeve të testimit me shkrim për t'i krahasuar ato me përgjigjet e dhëna nga vetë kandidati ose në rast ankimimi të vlerësimit për intervistën e strukturuar, rivlerësimi i saj nga komisioni është kryer në prani të kandidatit. Për të adresuar problematikën e mësipërme, një nga masat që parashikohet të vihet në zbatim vitin e ardhshëm, është aplikimi i **e-testing** që konsiston në zhvillimin e testimit elektronikisht dhe vlerësimin e tij automatikisht në kohë reale. Përveç sa më sipër, nisur nga problemet e ndeshura në praktikë u pa e nevojshme të ndryshohej skema e vlerësimit të kandidatëve për pranim në shërbimin civil, me qëllim sigurimin e një menaxhimi më efektiv të procedurave të rekrutimit dhe paraseleksionimit të kandidatëve më të kualifikuar. Për këtë arsye në Dhjetor 2018 u miratuan ndryshimet përkatëse në dy Vendimet e Këshillit të Ministrave që rregullojnë procedurat e konkurimit³⁵. Gjithashtu, bazuar në kërkesat për informacion që DAP administron nga të interesuarit përmes e-mailit dhe rrjetit social facebook, duke synuar sqarimin e një numri sa më të lartë individësh, gjatë vitit 2018 DAP ka vijuar punën intensive me publikimin në rrjete sociale të përgjigjeve për pyetjet më të shpeshta lidhur me mënyrën e aplikimit, fazat e konkurimit etj.

Përgjatë vitit 2018, në kontekstin e zbatimit të reformës në administratën publike puna u fokusua në:

- > *Vazhdimin e implementimit dhe garantimit të zbatimit rigoroz të legjislacionit për nëpunësin civil në të gjitha institucionet e administratës shtetërore, nëpërmjet koordinimit*

³⁵ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 746, datë 19.12.2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive"
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 748, datë 19.12.2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, "Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese"

me të gjitha njësitë e burimeve njerëzore për njohjen, unifikimin dhe mbikqyrjen e të gjitha procedurave për përmirësimin e performancës së administratës publike;

- > Përmirësimin e kuadrit rregullator për shërbimin civil;*
- > Përmirësimin e procesit të përzgjedhjes dhe vlerësimit të kandidatëve që konkurojnë për t'u bërë pjesë e administratës shtetërore;*
- > Forcimin e kapaciteteve të DAP dhe njësive të burimeve njerëzore në institucionet e administratës shtetërore, për të çuar përpara reformën në shërbimin civil nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme për kuptimin e politikave të menaxhimit të burimeve njerëzore, ndërlidhjen dhe efektet e tyre;*
- > Zhvillimin e mëtejshëm të metodave inovative për të përmirësuar dhe lehtësuar komunikimin dhe ndërveprimin mes institucioneve publike dhe qytetarëve;*
- > Forcimin e vazhdueshëm të ASPA si ofrues i trajnimeve për shërbimin civil dhe jo vetëm;*
- > Shtrirjen e SMIBNJ/HRMIS në institucionet e administratës shtetërore jo pjesë e shërbimit civil, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore dhe Implementimi i modulit të pagave nëpërmjet SIMBNJ/HRMIS.*


Më poshtë paraqiten arritjet konkrete kundrejt objektivave. ***Me qëllim përmirësimin e procesit të rekrutimit dhe plotësimin e nevojave institucionale, Departamenti i Administratës Publike, gjatë vitit 2018 ndërmorri një sërë masash në drejtim të:***

- > Pasurimit dhe përmirësimit cilësor të pyetjeve në bankën e pyetjeve, aktivitet i cili parashikohet të zhvillohet më tej në kuadër të projektit IPA 2014 “Zbatimi i reformës së Shërbimit Civil në administratën Publike”;*
- > Trajnimit të anëtarëve të rinj të Komiteteve të Përhershme të Pranimi mbi metodologjinë dhe teknikat e sakta të vlerësimit të kandidatëve;*
- > Bashkëpunimit me institucionet e arsimit të lartë me qëllim informimin e kandidatëve potencialë (studentët dhe të sapodiplomuarit) lidhur me mundësitë e punësimit në administratën shtetërore, etj.*

Edhe gjatë vitit 2018 është punuar në drejtim të ***përmirësimit të procesit të rekrutimit në shërbimin civil në të gjitha etapat e tij*** duke nisur nga planifikimi i vendeve vakante, grupimi dhe shpallja e tyre, orientimi i publikut lidhur me mënyrën e saktë të aplikimit dhe menaxhimi i procesit të rekrutimit në mënyrë efektive nëpërmjet implementimit të metodave inovative

Numri mesatar i kandidatëve për një pozicion për vitin 2018 llogaritet të jetë 22. Siç mund të vihet re nga grafiku i mëposhtëm, numri mesatar i aplikantëve për pozicion ka pësuar rritje në krahasim me vitet e mëparshme, gjë që tregon për një interesim në rritje për t'u bërë pjesë e shërbimit civil.

Grafiku 16. Numri mesatar i aplikantëve për periudhën 2001-2018



Janë hedhur *hapa konkrete drejt mundësisit të gjenerimit të pagave të punonjësve të administratës nëpërmjet HRMIS*, proces ky i cili po zbatohet në 90 institucione shtetërore. Nga këto 82 Institucione të administratës shtetërore pjesë e shërbimit civil; 3 Institucione të administratës shtetërore jo shërbim civil; si dhe 5 Institucione të pavaruara.

Gjithashtu, Sistemi Informatik i Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) është pasuruar më tej më të dhëna nga institucionet e administratës publike, institucionet e pavarura dhe njësitë e qeverisjes vendore, duke bërë të mundur që të hidhen në sistem mbi 790 institucione dhe informacion për mbi 50,000 të punësuar. Janë trajnuar *mbi 230 nëpunës* të sektorëve të burimeve njerëzore dhe janë organizuar gjithsej 30 trajnime ku 18 trajnime janë për Burimet Njerëzore dhe 12 trajnime për Punonjësit e Financave të institucioneve.

Në kuadër të mbështetjes së Bashkimit Evropian në zbatimin e Reformës në Administratën Publike gjatë vitit 2018, kanë nisur zbatimin disa projekte të rëndësishme me përfitues kryesor Departamentin e Administratës Publike, e konkretisht:

- **Projekti IPA 2014 “Krijimi i zgjidhjeve kompjuterike për të mundësuar zbatimin e disa komponentëve dhe mekanizmave të kontrollit”**

Në muajin Dhjetor 2018, Departamenti i Administratës Publike nënshkroi kontratën për zbatimin e projektit IPA 2014 **“Krijimi i zgjidhjeve kompjuterike për të mundësuar zbatimin e disa komponentëve dhe mekanizmave të kontrollit”** të financuar nga Bashkimi Evropian. Qëllimi i këtij projekti është të mundësojë me anë të zgjidhjeve kompjuterike zbatimin më të mirë të mekanizmave të kontrollit mbi:



- funksionalitetin e Sistemit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (HRMIS) nëpërmjet përdorimit të certifikatave elektronike;
- zhvillimin e një sistemi informacioni për të përmirësuar proceset e vlerësimit dhe testimit të punonjësve në shërbimin civil;

- zhvillimin e një sistemi me qasje dhe monitorim të centralizuar i cili do të standardizojë proceset qeveritare të administratës publike shqiptare;
- zhvillimin e një platforme kompjuterike të centralizuar e cila do të lehtësojë dhe standardizojë grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave lidhur me nëpunësit civilë.

➤ **Projekti IPA 2015 “Skema e bursave për nëpunësit e rinj civilë”**

Gjatë vitit 2018 Departamenti i Administratës Publike në bashkëpunim me Shkollën Kombëtare të Administratës Publike Franceze (ENA) dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) vijoi me zbatimin e projektit të financuar nga Bashkimi Evropian “Skema e Bursave për Nëpunësit e Rinj Civilë”³⁶. Ky projekt i cili nisi në 11 Shtator 2017 e përfundoi në 11 Korrik 2018, kishte si kishte si qëllim mbështetjen e reformës në shërbimin civil në ngritjen e një sistemi profesional, të pavarur dhe të bazuar në meritë, në përputhje me standardet evropiane, si dhe rritjen e atraktivitetit të shërbimit civil për profesionistët e rinj.

Në kuadër të këtij projekti, Delegacioni i BE-së në Shqipëri kontrakttoi Shkollën Franceze të Administratës Publike "Ecole National d'Administration" (ENA), e cila në bashkëpunim me Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) hartoi dhe zbatoi programin e një trajnimi specifik dhe praktik për 15 nëpunës civil të rinj nga administrata shtetërore shqiptare dhe institucionet e varësisë të përzgjedhur përmes një procedure rigoroze konkurruese, transparente, bazuar në meritë.



Kohëzgjatja e këtij programi trajnimi ishte 4 muaj: 0.5 muaj trajnim paraprak në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), 3.5 muaj sesione trajnimi praktik pranë ENA-s në Paris dhe Strasburg ku u përfshi dhe një vizitë studimore në institucionet e BE-së.

Pjesëmarrësit u zgjodhën nga katër fusha kryesore horizontale që mbulonin politikat publike; monitorimin dhe zbatimin e strategjisë; hartimin e legjislacionit; integrimin evropian, planifikimin e buxhetit dhe menaxhimin financiar.

Programi i trajnimit përmbante një varietet modulesh, të cilat mbuluan tema të lidhura me politikat publike, qeverisjen për qytetarët dhe integrimin evropian. Sesionet e trajnimit në ENA ishin

³⁶ Të gjitha materialet e hartuara nga projekti në bashkëpunim me institucionet shqiptare mund të gjenden online në faqen zyrtare të projektit <http://ycsalbania.eu/>

ndërvepruese, duke u përqendruar në shembuj konkretë, misione dhe aktivitete të administratës publike, raste studimore dhe ushtrime të tjera. Këto të fundit u përfshinë argumente verbale, diskutime në grupe dhe krijimin e një mjedisi stimulues të mësimdhënies dhe vlerësimin e përparimit të kolegëve. Pjesë e programit të trajnimit ishin gjithashtu vizitat në institucione të përzgjedhura franceze dhe Evropiane të administratës publike. Në përfundim, 15 nëpunësit që përfituan nga ky trajnim ishin subjekt i një testimi final të organizuar nga ENA.



Në përmbyllje të projektit u organizua ceremonia e diplomimit ku 15 të sapodiplomuarit shprehën entuziazmin mbi këtë eksperiencë unike dhe motivimin për të ndarë njohuritë e përfituara me kolegët e tyre në drejtim të përmirësimit të performancës së administratës publike.

➤ **Projekti IPA 2015 “Reforma e Administratës Publike në Shqipëri – Komunikimi dhe Vizibiliteti”**

Në kuadër të zbatimit të projektit “Reforma e Administratës Publike në Shqipëri – Komunikimi dhe Vizibiliteti”, DAP në bashkëpunim me delegacionin e Bashkimit Evropian në Tiranë, realizoi një video (pjesë e një dokumentari) ku tregohet: *përmirësimi i procedurave të rekrutimit, shpallja dhe aplikimi online për vendet vakante, procedura e pranimit* etj. Po nëpërmjet këtij projekti u lançua në formën e një thirrjeje për të gjithë të rinjtë që dëshirojnë t’i bashkohen administratës publike, një spot radiofonik që u transmetua në radion kombëtare Club FM. Janë botuar gjithashtu, artikuj në shtypin e shkruar dhe median online për risitë në shërbimin civil, si: mënyra e rekrutimit online apo trajnimet jashtë vendit në disa nga shkollat më të mira në botë. Gjithashtu janë përgatitur broshura, fletëpalosje dhe postera të ndryshëm informues për qytetarët për reformën në administratën publike dhe mundësitë e punësimit në shërbimin civil.

➤ **Projekti IPA 2014 “Zbatimi i Reformës së Shërbimit Civil në Administratën Publike”**

Në muajin Tetor 2018 ka nisur të zbatohet projekti IPA 2014 i financuar nga Bashkimi Evropian “Zbatimi i reformës së shërbimit civil në administratën publike”. Fokusi i projektit, i cili parashikohet të zgjasë 30 muaj, është reforma në strukturën e pagave, përcaktimi i kriterëve të performancës së punonjësve dhe institucioneve, krijimi i një sistemi të unifikuar të burimeve njerëzore për të gjithë administratën publike qendrore dhe lokale, përforcimi i rolit monitorues të Departamentit të Administratës Publike dhe Komisionerit për Mbikqyrjen e Shërbimit Civil, si dhe forcimi i Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA).

Duke marrë parasysh se procesi i reformës së administratës publike në Shqipëri dhe përafrimit të tij me standardet e BE-së janë kushte thelbësore për anëtarësimin e ardhshëm të Shqipërisë në BE, ky projekt do të vijojë të mbështesë Departamentin e Administratës Publike dhe organet e tjera të

mbikëqyrjes në standardizimin dhe unifikimin e menaxhimit të shërbimit civil, me qëllim krijimin e një shërbimi civil të pavarur, transparent dhe profesional në nivel qendror, lokal dhe në komunikimin me institucionet relevante.

Projekti në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Administratës Publike tashmë ka nisur punën për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara sipas afateve të parashikuara. Vlen të përmendet se këto masa janë reflektuar edhe në Planin e ri të Veprimit 2018-2022 të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike si aktivitete me ndikim të tërthortë/ndërsektorial.

Siç parashikohet në rregulloren e projekteve IPA, 3 muajt e parë përkojnë me përgatitjen e “raportit paraprak/fillestar” në të cilin përshkruhen në mënyrë të detajuar gjetjet e ekspertëve të projektit gjatë periudhës së fillimit, siç është analizimi i legjislacionit dhe situatës aktuale në lidhje me objektivat dhe qëllimin e projektit. Më tej, projekti do të vijojë zbatimin e aktiviteteve sipas parashikimeve për secilin prej komponentëve gjatë vitit 2019 dhe do të zgjasë deri në vitin 2021.

Ndërkohë, gjatë vitit 2019 puna do fokusohet në ofrimin e zgjidhjeve konkrete për të përmirësuar ndër të tjera: (i) sistemin e pagave në shërbimin civil (sistemin e shpërblimit të nëpunësve civilë); (ii) vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë; (iii) klasifikimin e pozicioneve dhe përshkrimet e punës; (iv) proceset e punës (manuali i procedurave); (v) forcimi i kapaciteteve të ASPA; (vi) procesin e monitorimit për të siguruar zbatimin e legjislacionit për nëpunësin civil dhe standarte koherente për të gjithë administratën publike.

Më poshtë një shpjegim i shkurtër për secilin nga aktivitetet e projektit për vitin 2019:

- **Zhvillimi i sistemit të ri të pagave të nëpunësve civilë dhe reformimi i sistemeve të pagave të administratës publike në tërësi.** Me qëllim përcaktimin e rrugës për zbatimin e sistemit të pagave të miratuar nga ligji nr. 152/2013, “Për shërbimin civil”, të ndryshuar, gjatë vitit 2019 do të përgatitet një studim analitik në të cilin do të identifikohen nevojat për ndryshim apo përshtatje të sistemit të ri të pagave, mënyrat e mundshme të zbatimit të sistemit të ri, si dhe standartet për sistemin e pagave në tërësi në administratën publike.
- **Manuali për vlerësimin e rezultateve** në punë do të përmbajë procedurat dhe shembujt e përdorur si “benchmarking/krahasuese” për vlerësimin e punës. Pasi të analizohet dhe vlerësohet situata ekzistuese, manuali për vlerësimin e rezultateve në punë do të ketë objektiva dhe indikatorë të përcaktuar qartë.
- **Metodologjia e klasifikimit të pozicioneve të punës dhe përshkrimeve të punës.** Në kuadër të këtij projekti do të analizohet metodologjia aktuale e klasifikimit të pozicioneve të punës dhe do të propozohen përmirësime të mundshme duke hartuar një katalog të dedikuar i cili do të përmbajë procedura dhe shembuj për benchmark-un e vlerësimit të pozicioneve. Gjithashtu do të hartohet katalogu i përshkrimeve të punës i cili do të mundësojë përmirësimin e cilësisë së përshkrimeve të punës sipas standardeve të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave dhe udhëzimin e DAP-it dedikuar përshkrimeve të punës.

- **Manuali i procedurave**, i cili do të përmbajë shembuj për proceset kryesore horizontale në ministritë e linjës dhe disa procese specifike të dedikuara për to, do të sigurojë unifikimin e procedurave në administratën publike dhe përmirësimin e performancës së nëpunësve publikë.
- **Forcimi i ASPA-s si institucioni qendror i vetëm për trajnimin dhe zhvillimin e kapaciteve të burimeve njerëzore të administratës publike, përfshirë edhe pushtetin vendor.** Nën këtë aktivitet ASPA do të mbështetet për (i) rishikimin dhe implementimin e kurrikulës për anëtarët e TND-së, (ii) zhvillimin e një modeli për menaxhimin cilësor të kurrikulave të trajnimit, (iii) hartimin e strategjisë për transformimin e ASPA-s në një qendër ekselence për trajnimin dhe zhvillimin e administratës publike.
- **Zhvillimi i mekanizmave të monitorimit për të siguruar zbatimin e legjislacionit për nëpunësin civil dhe standarte koherente për të gjithë administratën publike.** Nën këtë aktivitet do të asistohet DAP-i për (i) përcaktimin e setit të indikatorëve dhe mekanizmave të tjerë të monitorimit dhe vlerësimit dhe (ii) standartizimin e procedurave të menaxhimit të burimeve njerëzore, si dhe KMSHC-ja për forcimin e procesit të mbikëqyrjes së implementimit të legjislacionit të shërbimit civil, me fokus në organet e vetëqeverisjes vendore.

Në lidhje me shkallën e zbatimit të rekomandimeve të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në institucionet e pushtetit qendror, vendor dhe ato të pavarura, situata paraqitet si më poshtë:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil (KMSHC), gjatë vitit 2018, ka shqyrtuar **105** informacione/ankesa, të zgjidhura nëpërmjet hetimit administrativ individual, apo duke u trajtuar në kuadër të proceseve të nisura të mbikëqyrjes.

Ka përfunduar procesi i mbikëqyrjes së përgjithshme apo inspektimit me vendim paralajmërimi për rregullimin e ligjshmërisë, në **54** institucione të tipologjive të ndryshme të administratës publike.

Në pjesën e parë të vitit 2018 **është finalizuar procesi i nisur në vitin 2017 për monitorimin e ristrukturimit të administratës shtetërore**, duke hartuar një raport të veçantë monitorimi për çdo institucion të përfshirë në të (në 11 Ministritë e linjës dhe Kryeministria). Në të gjitha rastet Komisioneri ka lënë detyra konkrete në institucionet e monitoruara në lidhje me këtë aspekt të zbatimit të ligjit, për punonjës në hierarki të ndryshme të shërbimit civil. Prosesi është realizuar brenda afateve dhe kërkesave të ligjit, duke i kushtuar një rëndësi e veçantë përfundimit të procesit të hartimit të përshkrimeve të punës i cili është konstatuar me parregullsi gjatë monitorimit (*aktet që materializojnë përshkrimin e punës, në këto institucione, janë të vjetëruara dhe kanë nevojë të menjëhershme për rinovim në lidhje me funksionet, detyrat, objektivat, kërkesat e veçanta të vendit të punës, etj., të cilat shpeshherë kanë ndryshuar edhe për shkak të miratimit të ligjeve që rregullojnë funksionimin e tyre*).

Pas verifikimit të zbatimit të detyrave të lëna nga Komisioneri, rezulton se procesi i përshkrimeve të punës ka përfunduar në institucionet qendrore të administratës shtetërore (*Ministritë e linjës dhe Kryeministria*), në përputhje me kërkesat e ligjit dhe akteve nënligjore.

Komisioneri ka punuar edhe në drejtim të administrimit të të dhënave dhe studimit të situatës në lidhje me nivelin e zbatimit të ligjit, ***në fushën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë***, për rikthimin në detyrë të nëpunësve gjyqfitues, si një moment i rëndësishëm i zbatimit të ligjit për nëpunësin civil. Janë mbledhur dhe administruar të dhënat në **112** institucione dhe në përfundim janë evidentuar **311** vendime të formës së prerë (në **209** raste (ose 67%) i përkasin administratës shtetërore; në **90** raste (ose 29 %), NJQV-ve dhe në **12** raste (ose 4%) institucioneve të pavarura), të cilat për arsye të ndryshme ende nuk janë ekzekutuar nga subjektet përkatëse. Gjatë këtij procesi janë evidentuar nevojat për ndryshime ligjore, si dhe për plotësime të akteve ekzistuese rregullatore që parashikojnë procedurat që duhet të zbatohen në këtë rast. Komisioneri po vijon procesin e hetimit administrativ për çdo rast të konstatuar në shkelje të ligjit nga institucionet e detyruara të zbatojnë vendimin e gjykatës.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes në vazhdim, i cili ka të bëjë me ndjekjen në vijim të procesit të zbatimit të vendimeve paralajmëruese të Komisionerit, rezulton se ky proces është kryer nëpërmjet verifikimeve në vend në **49** institucione të përfshira në mbikëqyrje nga të cilat **16** i përkasin administratës shtetërore (institucione varësie) dhe **33** njësive të qeverisjes vendore (*1 këshill qarku dhe 32 bashki*).

Në përfundim të verifikimit, mbikëqyrja në vazhdim është përmbyllur me vendim të Komisionerit në **26** raste ose 53% të tyre (bëhet fjalë për 15 institucione varësie të administratës shtetërore, 10 bashki dhe 1 këshill qarku) pasi institucionet kishin realizuar plotësisht detyrat e lëna nga Komisioneri dhe në **23** raste ose 47% të tyre procesi është duke vijuar në fazat e ndryshme të tij (bëhet fjalë për 22 bashki dhe 1 institucion varësie të administratës shtetërore).

Në kushtet kur subjektet kanë zbatuar vullnetarisht vendimet paralajmëruese, si në rastin e mbikëqyrjeve/inspektimeve, ashtu edhe të vendimeve individuale për zgjidhjen e ankesave, Komisioneri nuk e ka aplikuar mjetin e gjobës.

Komisioneri vlerëson progres të ndjeshëm në drejtim të rritjes së nivelit të zbatimit të ligjit për nëpunësin civil, krahasuar me periudhat e mëparshme të raportimit.

Ky konkluzion bazohet në mënyrë të veçantë:

a) në konsolidimin e procesit të rekrutimit në administratën qendrore. Komisioneri ka realizuar monitorimin e procesit të rekrutimit pranë DAP, për periudhën Janar - Dhjetor 2018, për plotësimin e **834** pozicioneve të punës (*nëpërmjet rekrutimit në grup, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë në administratën shtetërore, si dhe në procedurat e realizuara për kategorinë TND*) nëpërmjet **484** procedurave të konkurrimit. Procesi paraqitet transparent dhe brenda kufijve proceduralë. Konstatohet respektimi i procedurave, në administratën shtetërore, ku vihet re: shtimi i numrit të konkurrentëve për një proces rekrutimi; zbatohet parimi i rekrutimit në grup; zbatohet parimi i transparencës së procesit në kushtet kur publikohen shpalljet në portalin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit dhe në portalin e Departamentit të Administratës Publike; respektohet e

drejta e ankimit të konkurrentëve, çka pasqyrohet në rritjen e numrit të konkurrentëve në fazën pas shqyrtimit të ankesave, si dhe në numrin e ulët të ankesave pranë Komisionerit.

b) në vendosjen e procesit të rekrutimit në kufijtë formalë ligjorë dhe proceduralë edhe në njësitë e qeverisjes vendore. Nga **1207** akte administrative të konstatuara në kundërshtim me ligjin nga Komisioneri, të nxjerra nga titullari i institucionit, për emërimë të përkohëshme në shërbimin civil, në 48 NJQV gjatë tre viteve, në **740** prej tyre (ose **61%**), situata është rregulluar në përputhje me ligjin, duke zbatuara detyrat e lëna nga Komisioneri. Në **467** raste (ose **39%** të tyre), aktualisht ka nisur procesi i rekrutimit nëpërmjet shpalljes së pozicioneve të lira dhe vijon me ritme të shpejta rikthimi i gjendjes së ligjshmërisë.

Por, nga ana tjetër, sfida e vazhdueshme e administrimit të shërbimit civil në administratën vendore, qendron në rritjen e nivelit të zbatimit të ligjit në të gjitha proceset e administrimit të shërbimit civil, nëpërmjet fuqizimit të kapaciteteve të njësive të menaxhimit të burimeve njerëzore.

Aktualisht numri i stafit të MBNJ në bashki dhe kapacitetet e tyre janë të kufizuara. Stafi i MBNJ në këto njësi ka një nivel të ulët të njohurive të përgjithshme ligjore lidhur me procese të ndryshme të administrimit të shërbimit civil, e po kështu edhe niveli i aftësive për të siguruar zbatimin e duhur është mjaft i mangët. Komisioneri vlerëson gjithashtu se mjetet në dispozicion të zbatimit të ligjit, sidomos në disa prej instituteve të tij (*në rastin e rekrutimit, përshkrimit të punës, vlerësimit të punës, sigurimit të efikasitetit dhe efektivitetit organizativ të administratës dhe shërbimeve të bashkisë, etj.*), mungojnë ose janë të pakta, janë të ndërlikuara dhe jo të lidhura me kontekstin e administratës vendore.

Në këto kushte, në lidhje me hartimin dhe propozimin ***për ndryshimet ligjore të domosdoshme për të unifikuar zbatimin e ligjit*** në administratën shtetërore dhe vendore Komisioneri vlerëson se ka lindur nevoja *për një legjislacion të ri, të posaçëm, për organizimin e administratës vendore, si dhe për të rishikuar dhe zgjeruar gamën e mjeteve që ka në dispozicion stafi i menaxhimit të burimeve njerëzore në NJQV-të për zbatimin e ligjit*. Po kështu nevojitet përshtatja e mjeteve ekzistuese të zbatimit të ligjit për burimet njerëzore të përgatitur nga DAP, me tiparet e identifikuar në nivel lokal, duke vlerësuar mundësinë e thjeshtimit të tyre për përdorimin e bashkive.

Nevojat për ndryshime ligjore, Komisioneri i ka parashtruar në Kuvendin e Shqipërisë nëpërmjet Raportit Vjetor për veprimtarinë e institucionit për vitin 2018, si edhe i ka adresuar për zgjidhje në bashkëpunim me ekspertë të specializuar, gjatë zbatimit të projektit IPA 2014 “Zbatimi i Reformës së Shërbimit Civil në Administratën Publike”.

Nxjerrja e udhëzimeve dhe rekomandimeve në lidhje me unifikimin e zbatimit të ligjit në shërbimin civil bazuar në problematikat e evidentuara nga Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në administratën publike ka vijuar gjatë vitit 2018 ku rezultoi se janë hartuar udhëzimet si më poshtë:

1. Udhëzim mbi mënyrën e trajtimit të nëpunësve civilë nga institucionet që dalin nga shërbimi civil (institucionet e administratës shtetërore);
2. Udhëzim në lidhje me procesin e ristrukturimit të institucioneve të administratës shtetërore dhe monitorimi i zbatimit të procedurave ligjore gjatë aplikimit të tij;

3. Udhëzim në lidhje me funksionimin e skemës së shërbimit civil në njësitë e qeverisjes vendore. Monitorimi i aplikimit të saj gjatë procesit të hartimit dhe miratimit të strukturës organizative në këto institucione ka vijuar.

Aktiviteti i Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA) gjatë vitit 2018 ka patur synimin kryesor përgatitjen e administratës publike shqiptare në sfidën e integritetit evropian dhe në zbatim të legjislacionit të shërbimit civil.

Prej Shtatorit 2018 ASPA ka hyrë në proces terësor ristrukturimi, me qëllim forcimin e saj institucional, përmirësimin e cilësisë së shërbimit të trajnimit, diversifikimin e portofolit të trajnimit, si dhe përgatitjen e saj për të mbështetur sfidën e administratës publike në procesin e integritetit evropian.

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) gjatë periudhës Tetor-Nëntor 2018 kreu procesin e *Analizës së Nevojave për Trajnim*, për të gjitha institucionet e shërbimit civil në rang vendi të administratës qendrore, vendore, si dhe institucionet e pavarura. Procesi i vlerësimit i kryer gjatë vitit 2018 kishte për qëllim evidentimin e nevojave për trajnim, në nivel institucioni dhe individ, për tre kategori të mëdha çështjesh që lidhen me nevojat për trajnim në kuadër të vënies në zbatim të detyrave funksionale, të procesit të integritetit evropian, si dhe të nevojave për përmirësim të komunikimit në gjuhë të huaj.

Gjatë këtij procesi janë kontaktuar 102 institucione ku përfshihen 12 ministri (së bashku me institucionet e varësisë), 61 bashki, 12 këshilla qarqesh, 17 institucione të pavarura (përfshirë institucionet e sistemit gjyqësor si dhe legjislativ). Nga përpunimi i të dhënave rezulton se, kanë sjellë nevojat për trajnim 74 institucione ose 72% e institucioneve të kontaktuara (100% e institucioneve qendrore, 67% e institucioneve vendore dhe 70% e institucioneve të pavarura), ndërsa në nivel individ kanë marrë pjesë 1770 individë ose 10% e totalit prej 16193 punonjësish në 102 institucionet e kontaktuara (*1026 individë të pushtetit qendror, 636 individë të pushtetit vendor dhe 108 individë të institucioneve të pavarura*)

Në përfundim rezulton se, në rang vendi dhe në nivel institucioni, janë paraqitur në total 40487 kërkesa për trajnim (34.830 kërkesa nga pushteti qendror, 3951 kërkesa nga pushteti vendor dhe 1706 kërkesa nga institucionet e pavaruar). Nga totali prej 40487, kemi

- 32236 kërkesa që lidhen me nevojat në kuadër të vënies në zbatim të detyrave funksionale (*29% kërkojnë nivel bazë njohurish, 39% kërkojnë nivel mesatar njohurish, 25% kërkojnë nivel të thelluar njohurish dhe 7% rezultojnë që nuk e kanë specifikuar nivelin e njohurive të kërkuara*);
- 3283 kërkesa që lidhen me procesin e integritetit evropian (*35% kërkojnë nivel bazë njohurish, 36% kërkojnë nivel mesatar njohurish, 25% kërkojnë nivel të thelluar njohurish dhe 4% rezultojnë që nuk e kanë specifikuar nivelin e njohurive të kërkuara*), si dhe

- 4968 kërkesa që lidhen me nevojat për përmirësim të komunikimit në gjuhë të huaj (38% kërkojnë nivel bazë njohurish, 30% kërkojnë nivel mesatar njohurish, 24% kërkojnë nivel të thelluar njohurish dhe 8% rezultojnë që nuk e kanë specifikuar nivelin e njohurive të kërkuara).

Nga analiza e të dhënave rezulton gjithashtu se 3 fushat më të kërkuara lidhur me nevojat në kuadër të vënies në zbatim të detyrave funksionale janë: Kodi i Procedurave Administrative; hartimi dhe menaxhimi i projekteve si dhe menaxhimi i riskut. Për tështje që lidhen me nevojat në kuadër të procesit të integritimit evropian 3 fushat më të kërkuara janë: mapëzimi i Acquis me politikat qendrore dhe lokale, përafrimi i legjislacionit, si dhe menaxhimi i fondeve të BE-së. Lidhur me nevojat për përmirësim të komunikimit në gjuhë të huaj, 3 gjuhët më të kërkuara janë: gjuha Angleze, gjuha Italiane si dhe gjuha Gjermane.

Gjatë Nëntorit 2018, bazuar në rezultatet e Analizës së Nevojave për Trajnim, ASPA ndërmori procesin e rishikimit të moduleve ekzistuese dhe hartimin e moduleve të reja, me qëllim që programet dhe trajnimet të jenë në përputhje me nevojat reale të administratës publike dhe kërkesat didaktike të procesit të të nxënimit tek të rriturit. Për këtë qëllim shkolla miratoi kriteret e hartimit të një moduli trajnimi. I gjithë ky proces i shërben qasjes së re të ASPA ndaj metodave për zhvillimin e trajnimit me të rriturit, duke vënë theksin tek nevoja që modulet të respektojnë sa më shumë kontekstin në të cilin të rriturit maksimalizojnë të nxënimit gjatë procesit të të mësuarit.

Mbështetur në këto kritere një modul trajnimi përmban:

- Materialin teorik i cili është një përmbledhje e literaturës bazë që trajton moduli. Në përmbajtjen e tij reflektohen kuadri ligjor në fuqi, si dhe politikat e zhvillimit strategjik kombëtar, sektorial dhe vendor.
- Materialin didaktik në cilin paraqitet në mënyrë të organizuar informacioni dhe veprimtaria didaktike e trajnimit në përputhje me metodat e të nxënimit të të rriturve. Në këtë material paraqiten objektivat e trajnimit, sekuencat e aktiviteteve, metodat e të nxënimit, rezultatet e të nxënimit, dhe skedat individuale të çdo aktiviteti me të gjitha detajet përmbajtësore dhe organizative.
- Bankën e pyetjeve e cila përmban pyetjet për kontrollin e njohurive. Pyetjet mund të jenë të llojeve të ndryshme, si pyetje riprodhuese, pyetje analitike dhe zbatuese si dhe pyetje përgjigjet e të cilave kërkojnë sintezë apo vlerësim.

Si rezultat gjatë vitit 2018, është ndërtuar një arkivë didaktike me 103 module trajnimi për 31 fusha ekspertize, prej të cilave 13 module u rishikuan, 74 module u hartuan të reja dhe 16 module që kishin një fillesë ekzistuese u hartuan nga e para.

Theksojmë së këto module do të jenë pjesë e programeve të reja që do të hartohen dhe zhvillohen duke siguruar cilësinë didaktike të trajnimit përgjatë vitit 2019 e në vijim.


Arritje të tjera të punës së ASPA kanë gjatë vitit 2018 kanë qenë:

- Trajnimi i 5554 nëpunësve të administratës publike, ku shënohet një rritje prej 14 % krahasuar me vitin 2017;
- Përcaktimi i kriterëve didaktike për hartimin e një moduli trajnimi;
- Fillimi i pilotimit të standardeve të cilësisë së trajnimit dhe menaxhimit të organizatës;
- Hartimi i procedurës së punës për hapje dhe mbyllje të klasës;
- Ngritja e databazave me një numër të konsiderueshëm treguesish për: programet dhe modulet e trajnimit; pjesëmarrësit në trajnim; trajnerët si dhe korrespondenca shkresore;
- Janë siguruar 1000 të drejta përdorimi të platformës e learning që ofron mundësinë për të mësuar dhe perfeksionuar gjuhën Angleze, Gjermane, Frënge, Italiane dhe Spanjolle në të gjitha nivelet.

Treguesit e ASPA për vitin 2018:

Indikatori	Vlera 2018
Nëpunës civilë pjesëmarrës në trajnime	5,554
Kurse trajnimi	270
Ditë trajnimi	726
Nëpunës civilë për ditë trajnimi	14,934

Grafiku 17. Statistika të trajnimit për periudhën 2013-2018



Ndër të tjera, gjatë vitit 2018 me mbështetjen e GIZ u realizua matja e ndikimit të trajnimit në performancën e nëpunësit civil. Matja e ndikimit u realizua për trajnimet në kuadër të rritjes së kapaciteteve për harmonizimin e legjislacionit ekonomik e tregtar të Shqipërisë me aktet e BE-së, për zbatimin e legjislacionit të harmonizuar si dhe përgatitja e administratës publike për zhvillimin e negociatave të anëtarësimit me BE-në

Indikatorët që lidhen me menaxhimin e trajnimit kanë vazhduar të shënojnë përmirësime si në aspektin sasior por veçanërisht në atë cilësor me zbatimin e standardeve të kontrollit dhe menaxhimit të cilësisë së kurrikulave dhe shtimin e numrit të ditëve të trajnimit mesatar për një nëpunës civil nëpërmjet hartimit, organizimit dhe zhvillimit të programeve afatgjata të trajnimit.

Në bashkëpunim me Prezencën e OSBE-së është zhvilluar matja e impaktit të trajnimit (vlerësimi ex-post) në lidhje me trajnimin e nëpunësve të administratës vendore, mbi çështjet e anti-korrupsionit. Instrumenti i përdorur në këtë vlerësim është pyetësori, i cili iu shpërnda pjesëmarrësve përpara dhe pas trajnimit, për të evidentuar njohuritë e fituara gjatë trajnimit përkundrejt njohurive para trajnimit si dhe përdorimin e njohurive të reja në punën e tyre.

Në përputhje me politikat e Bashkimit Europian për Edukimin e vazhduar dhe Trajnimin janë hulumtime të shumta me synimin ngritjen e një sistemi për menaxhimin e cilësisë së trajnimeve dhe njohjen e programeve bazuar në European Credit System for Vocational Education and Training (ECVET). Për realizimin e këtij objekti ASPA po mbështetet dhe nga ekspertë të projektit IPA 2014 “Zbatimi i Reformës së Shërbimit Civil në Administratën Publike”.

Gjatë vitit 2018 ka filluar procesi i “Programeve Komerciale” ku janë zhvilluar programi i zhvillimit të karrierës për kandidatët jashtë shërbimit civil që dëshirojnë të ndjekin programet e trajnimit të ASPA-s dhe programi “Startup school” i cili ofron përgatitje paraprake për kandidatët jashtë shërbimit civil (të rinjtë dhe të sapodiplomuarit) që synojnë të bëhen pjesë e shërbimit civil. Gjithashtu konsolidimi i politikave të tarifimit të këtyre programeve me pagesë mbetet objektiv për vitin 2019.

Në kuadër të zbatimit të objektivit strategjik ASPA synon që të ketë një sistem të vetëm për menaxhimin e proceseve të punës dhe të informacionit. Në këtë kuadër është realizuar ndërtimi logjik i databazave që do të jenë pjesë e sistemit si dhe është bërë popullimi i tyre me të dhëna. Objektiv për 2019 mbetet integrimi i këtyre databazave në një sistem të vetëm.

Me qëllim rritjen e cilësisë së trajnimit si dhe të paturit kurrikula cilësore në përputhje me standardet dhe metodologjinë e zhvillimit të trajnimit (implementimi i metodave inovative), ASPA ka përdorur platformën e-learning si një metodologji të re trajnimi që është e aksesueshme në faqen zyrtare të saj.

ASPA gjatë vitit 2018 ka konsoliduar librarinë dixhitale³⁷ duke e pasuruar me kurrikula për pushtetin qendror dhe vendor. Gjithashtu u konsolidua “Metodologjia e Vlerësimit të Cilësisë, bazuar në standarte dhe kritere”. Gjatë vitit 2018 janë publikuar në e-librari 89 kurrikula. Tematikat sipas materialeve kurrikulare dhe manualët përkatës janë ofruar për të kaluar paraprakisht sistemin e vlerësimit të cilësisë (SVC). Sipas Sistemit të Vlerësimit të Kurrikulave (SVC) deri tani janë vlerësuar gjithsej 89 module trajnimi (nga 76 module të vlerësuara deri në vitin 2017), ku mund të përmenden module të trajnimit të detyruar për pranimin në shërbimin civil për administratën vendore dhe qendrore, menaxhimi i fondeve të BE-së, Prokurimi Publik, Menaxhimi i mbetjeve urbane, Menaxhimi i Financave Vendore.

Tashmë ASPA ka një bibliotekë dixhitale (e-Library) të përbërë nga kurrikula të programeve të trajnimit për administratën publike në nivel qendror e vendor. Kjo platformë u ofron përdoruesve

³⁷ Libraria dixhitale është një sistem inteligjent i ndërtuar në faqen zyrtare që realizon menaxhimin e të gjithë kurrikulave të trajnimit që përdor Shkolla Shqiptare e Administratës Publike për trajnimin e nëpunësve civilë dhe të punonjësve të tjerë buxhetorë.

mundësinë të aksesojnë 89 kurrikula të ndryshme të programeve të trajnimit të vlerësuara nga ekspertë të fushës. Aktualisht numërohen **1322 përdorues**.

Me qëllim përmirësimit të cilësisë së kurrikulave u rishikua metodogjia ekzistuese e Vlerësimit të Kurrikulave (SVC) dhe u hartua dhe miratua “Udhëzuesi për hartimin /rishikimin e kurrikulave” i cili u vu në zbatim në fund të vitit 2018 gjatë procesit të hartimit/rishikimit të kurrikulave të trajnimit. Si rezultat i këtij procesi, bazuar në Analizën e Nevojave për Trajnim realizuar në muajin nëntor u krye procesi i rishikimit/hartimit të kurrikulave të reja. Si rezultat u hartuan 31 kurrikula, 108 module trajnimi (90 module të reja dhe 13 module të rishikuara) dhe u kontraktuan 29 ekspertë.

Ndër të tjera, gjatë vitit 2018 u realizua matja e ndikimit të trajnimit³⁸ në performancën e nëpunësit civil. Matja e ndikimit u realizua për trajnimet në kuadër të rritjes së kapaciteteve për harmonizimin e legjislacionit ekonomik e tregtar të Shqipërisë me aktet e BE-së, për zbatimin e legjislacionit të harmonizuar si dhe përgatitja e administratës publike për zhvillimin e negociatave të anëtarësimit me BE-në.

Indikatori 6a.	Vlera 2018
----------------	------------

Qarkullimi vjetor i stafit të nivelit drejtues në të gjitha nivelet e shërbimit civil në institucionet e administratës qendrore	7.8%
---	------

Ky indikator llogaritet duke pjesëtuar numrin e stafit drejtues në të gjitha nivelet e shërbimit civil në institucionet e administratës qendrore të cilët janë larguar nga pozicionet e tyre në një vit me numrin total të stafit drejtues në administratën qendrore në vitin e dhënë. Numri i stafit drejtues të larguar gjatë vitit 2018 është 81 nga totali i stafit drejtues prej 1036.

Indikatori 6 b 1.	Vlera 2018
-------------------	------------

Numri mesatar i pjesëmarrësve nga jashtë shërbimit civil që marrin pjesë në një procedurë rekrutimi	13 ³⁹
---	------------------

Ky indikator llogaritet duke pjesëtuar numrin total të pjesëmarrësve nga jashtë shërbimit civil që aplikojnë për një pozicion ekzekutiv (11688) me numrin total të pozicioneve të shpallura në kategorinë ekzekutive në vitin e dhënë (897).

Indikatori 6b 2.	Vlera 2018
------------------	------------

Numri mesatar i pjesëmarrësve brenda shërbimit civil që marrin pjesë në një proces rekrutimi	1.5 ⁴⁰
--	-------------------

³⁸ Nga analiza e të dhënave rezultoi se: (i) 82% e pjesëmarrësve vlerësojnë se aftësitë e fituara nga të trajnuarit ishin të nevojshme dhe demonstrojnë sukses në mënyrën e përgatitjes dhe zhvillimit të trajnimit; (ii) Trajnimet e kryera ia kanë arritur qëllimit nëpërmjet kombinimit të formimit teorik me ushtrimin praktik të aftësive të fituara, si dhe në përdorimin e aftësive të fituara në vendin e punës shumica e të intervistuarve e kanë gjetur hapësirën.

³⁹ Shënohet mitje me 3.1

⁴⁰ Shënohet mitje me 0.13

Numri total i pjesëmarrësve nga shërbimi civil (të gjitha grupet) për vitin 2018 është **1537**. Ndërsa numri total i pozicioneve për të cilat ka patur aplikime ishte 1013.

Përsa i takon indikatorit të mëposhtëm 6c, nga viti 2014 numri i çështjeve të gjykuara nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, me objekt procedura rekrutimi ka qenë 17, nga të cilat vetëm në 1 rast ankesa është pranuar pjesërisht nga shkalla e parë, dhe aktualisht është në proces gjykimi në Gjykatën e Apelit Administrativ. Rastet e tjera janë të rrëzuara/pushuar gjykimi. Nisur nga vlerat 0 apo 1 të këtij indikatorit ndër vite, sugjerohet rishikimi i tij dhe formulimi i një indikatorit tjetër i cili do të masë më saktë ç'ka synohet të arrihet me këtë objektiv.

<i>Indikatori 6c.</i>	Vlera 2018
Numri i ankesave që kanë të bëjnë me rekrutimin në shërbimin civil të pranuar nga gjykata (duke filluar nga gjysma e dytë e vitit 2014) ka shënuar rënie	0

Vlera e indikatorit të mëposhtëm ka vijuar të mbetet konstante nga vlerësimi i vitit 2015 i SIGMA.

<i>Indikatori 6d.</i>	Vlera 2018
Shkalla në të cilën sistemi i trajnimit të nëpunësve civilë është funksional dhe zbatohet në praktikë (Indikatori i SIGMA-s)	3

Në drejtim të **Objektivit 7 “Organizimi i sistemit të pagave në shërbimin civil duke u bazuar në vlerësimin e vendit të punës, të arritjeve vjetore të nëpunësve civilë dhe rezultateve në trajnimet e detyrueshme”** janë parashikuar 3 produkte, 2 për të cilat është parashikuar të nisë zbatimin i tyre nëpërmjet Projektit IPA 2014 “Zbatimi i reformës së shërbimit civil në administratën publike”.

<i>Indikatori 7a.</i>	Vlera 2018
Tarimi i sistemit të pagave dhe arritja e raportit 22:1 në vitin 2020, ndërmjet pagës maksimale dhe minimale.	8.6

Ky indikator paraqet raportin e pagës maksimale në administratën publike (paga e Presidentit të Republikës së Shqipërisë) me pagën minimale në administratën publike. Ky indikator nuk ka ndryshim krahasimisht me vitin 2017 pasi paga e Presidentit është e pandryshuar në nivelin 257'000 lekë dhe paga minimale në administratën publike vazhdon të jetë 30'000 lekë.

<i>Indikatori 7b.</i>	Vlera 2018
Rritja e variacionit/ numrit të pozicioneve në skemën e pagave bazuar në përshkrimin e punës	0

Një nga objektivat e rëndësishme të reformës së shërbimit civil dhe vetë Strategjisë është ai i organizimit të sistemit të pagave në shërbimin civil duke u bazuar në vlerësimin e pozicionit të punës, të arritjeve vjetore të nëpunësve civilë dhe rezultateve në trajnimet e detyrueshme

(Objektivi 7). Projekti IPA 2014 “Zbatimi i reformës së shërbimit civil në administratën publike” do të mbështesë administratën në realizimin e masave të parashikuara për këtë objekt. Projekti ka nisur në Tetor 2018 dhe gjatë periudhës Shkurt-Dhjetor 2019 janë parashikuar të zhvillohen aktivitete të cilat lidhen me organizimin e sistemit të pagave. Ndërkohë në fundin e vitit 2018 ka filluar puna për hartimin e strukturës së studimit analitik për strukturën e re të pagave.

Indikatori 7c.	Vlera 2017
Shkalla në të cilën sistemi i shpërblimit të nëpunësve civilë është i drejtë dhe transparent dhe zbatohet në praktikë (Indikatori i SIGMA-s)	3

Në vlerësimin e OECD/SIGMA ky tregues ka pësuar rënie nga niveli 4 në vitin 2015 në nivelin 3 në vitin 2017, duke nënvizuar faktin që vlerësimi “*promovimi vertikal dhe rritja e pagave mbeten të vetmet mënyra për të përmirësuar kushtet e pagave*” dhe ndryshimet e bëra në legjislacionin shqiptar ende nuk po sigurojnë një sistem koherent të pagave. Përsa i takon vitit 2018, nuk ka një vlerësim të këtij indikatori nga SIGMA, ndërkohë që në kuadër të projektit IPA 2014 “Zbatimi i reformës së shërbimit civil në administratën publike” do të realizohet një studim i cili do t’i hapë rrugë përmirësimit të sistemit të pagave dhe zvogëlimin të hendekut me tregun privat.


Shtylla IV – Procedurat Administrative dhe Mbikëqyrja

Reformat e parashikuara në këtë fushë orientohen drejt arritjes së katër objektivave të mëposhtme:


- ❖ *Zbatimin e procedurave të thjeshtuara për ofrimin e shërbimeve duke lehtësuar komunikimin me publikun dhe shmangur korrupsionin;*
- ❖ *Zhvillimin e një infrastrukture TIK të aftë për të mbështetur veprimtaritë e përditshme të administratës publike dhe rritjen e efikasitetit duke ulur kohën për të aksesuar, përpunuar dhe transmetuar informacionin ndërsa përmirësohet rrjedha e informacionit;*
- ❖ *Rritjen e efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së nëpunësve publikë;*
- ❖ *Rritjen e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike, garantimi i të drejtave të qytetarëve dhe aksesit në informacion.*

Kjo shtyllë përmban 30 produkte nga të cilat 27 kanë filluar zbatimin, nga ku 4 aktivitete janë realizuar plotësisht.

Grafiku 18. Numri i produkteve në zbatim sipas Objektivave



Grafiku 19. Statusi i realizimit të produkteve sipas Objektivave



Progresi kundrejt secilit objektiv

Në kuadër të **Objektivit 8** “Procedura të thjeshtuara për ofrimin e shërbimeve duke lehtësuar komunikimin me publikun dhe shmangur korrupsionin” janë parashikuar gjithsej 13 produkte të cilat kanë filluar të gjitha zbatimin deri në fund të vitit 2018 .

Në lidhje me realizimin e **verifikimit të proceseve të punës për ofrimin e shërbimeve publike** ADISA, me mbështetjen e projektit financuar nga fondet e BE-së “Mbështetje për përmirësimin e

ofrimit të shërbimeve publike me në qendër qytetarin”, ka ndërtuar platformën për inventarizimin e shërbimeve publike. Kjo Platformë është konceptuar si një ndërveprim mes institucionit dhe ADISA-s për shkëmbim të dhënash mbi shërbimet publike. Informacioni i gjeneruar nga Platforma IPSD do të shërbejë për të ndjekur në vijim procesin e derregulimit dhe standardizimit të shërbimeve publike duke gjeneruar Kartelat Informative, Formularët e Aplikimit si dhe për gjenerimin e raporteve të ndryshme në kuadër të procesit të derregullimit. Sa më sipër e në vijim të bashkëpunimit ndërinstitutional, ADISA është angazhuar në 3 faza, përkatësisht: (i) prezantimi i Platformës tek institucionet publike, (ii) Vlerësimi i listës së shërbimeve dhe (iii) plotësimi i Platformës.

(i) Prezantimi i Platformës IPSD në grupet e punës pranë institucioneve

Përfaqësuesit e ADISA si dhe ekspertët e projektit IPSD kanë zhvilluar prezantimin dhe trajnimin e grupeve të punës të ngritura në ministri/institucione varësie. Gjatë periudhës Korrik – Dhjetor 2018 është realizuar prezantimi i Platformës IPSD në 53 institucione. Në përfundim të trajnimit anëtarët e grupeve të punës janë pajisur me kredencialet për të procesuar me plotësimin e rubrikave të platformës.




Figura 3. Faqja kryesore Platformës IPSD

(ii) Validimi i listës së shërbimeve

Gjatë 6 mujorit të dytë kanë vijuar takimet me institucionet publike, me qëllim analizimin e bazës ligjore të secilit prej tyre dhe validimit të shërbimeve të tyre dhe gjatë gjithë vitit 2018 janë validuar shërbimet e 48 institucioneve publike.

(iii) Plotësimi i rubrikave të Platformës IPSD me informacionin për çdo shërbim

Në vijim të validimit të listës së shërbimeve për institucionet publike si më sipër, Sektori i Ri-inxhinierimit dhe Marrëdhënieve Institucionale ka asistuar institucionet në plotësimin e platformës IPSD, me informacion për shërbimet publike. Gjatë këtij 6 muaji është realizuar gjithashtu popullimi i Platformës IPSD për 46 institucione. Në përfundim të këtij procesi bëhet i mundur gjenerimi i Kartelës Informative për secilin shërbim. Më pas këto kartela informative të standardizuara publikohen në faqen zyrtare të institucionit ADISA dhe njëkohësisht dhe në Call Center.


Në kuadër të prioritetit të Qeverisë Shqiptare për përmirësimin e shërbimeve publike dhe në zbatim të Ri-inxhinierimit të shërbimeve publike ku në fokus janë përzgjedhur 15 institucione nga kabineti i Zv/ Kryeministrit, gjatë vitit 2018 u kërkuar asistencë e ADISA-s në mënyrë që këto institucione të realizojnë ri-inxhinierimin e shërbimeve të ofruara nga këto të fundit. Gjatë kësaj periudhe laborator i ideve inovative “ADISALab”, në mbështetje të institucionit të Kryeministrit, ka punuar për projektin “Life Event”. “Life events” janë paketa shërbimesh të krijuara për të mundësuar ofrimin e disa shërbimeve nga institucione të ndryshme, me një aplikim të vetëm. ADISALab aktualisht ka përgatitur dy paketa shërbimesh të cilat synon t’i implementojë brenda vitit 2018 përkatësisht: (i) Paketa e Lindjes dhe (ii) Migrimi. Gjithashtu ka filluar puna për përgatitjen e tri paketave të tjera të cilat pritet të implementohen gjatë vitit 2019. Së fundmi, për të lehtësuar qytetarët në marrjen e informacionit për shërbimet e lidhura me ngjarje të ndryshme jetësore, janë krijuar Paketat informuese të cilat ofrojnë informacion të detajuar mbi: martesën, aplikimin për pasaportë, regjistrimin e mjeteve, pensionin e pleqërisë, punësimin, banesat, arsimin, si dhe Kontratat Utilitare (OSHEE, UK).

Gjatë kësaj periudhe ka vijuar puna për hartimin dhe përditësimin e formularëve të aplikimit. Gjatë vitit 2018 janë standardizuar 176 formularë aplikimi dhe janë përditësuar 72 të tillë. Në total janë standardizuar 296 formularë dhe janë në përdorim 234 formularë aplikimi të cilët mbulojnë rreth 460 shërbime për 18 institucione.

Në këtë drejtim është forcuar bashkëpunimi me 43 institucione duke plotësuar platformën (IPSD) e dizenuar për inventarizimin e shërbimeve publike. Nga këto 43 institucione, 27 janë institucione të reja me të cilat nuk ka patur më parë bashkëpunim.

Ka vijuar informimi i qytetarëve dhe gjatë kësaj periudhe janë informuar 8,038 qytetarë, ndër të cilët 7 nga 10 informohen plotësisht. Nga të dhënat e monitoruara rezulton se numri i telefonatave të kryera nga meshkujt dhe nga femrat është afërsisht i njëjtë, përkatësisht 51% e telefonatave nga femrat dhe 49% e telefonatave nga meshkujt. Pothuajse të gjitha telefonatat janë kryer nga zonat urbane, përkatësisht 98% e telefonatave nga zonat urbane dhe 2% nga zonat rurale. Qytetarët informohen më së shumti për Call Center ADISA nga kanalet online, përkatësisht 92% e tyre. Ndërkohë 4 nga 10 qytetarë janë telefonues besnikë.

Të dhënat e disagreguara sipas gjinisë



Të dhënat e disagreguara sipas zonës së banimit



Grafiku 20. Disagregimi i të dhënave të Call Center sipas gjinisë dhe zonës

Indikatori 8a.

Vlera 2018

Numri i shërbimeve me procedura të thjeshtësuara për ofrimin e tyre

0


Niveli faktik i këtij indikatori për vitin 2018 është 0. Produktet e konsulencës për ri-inxhinierimin e shërbimeve publike të 10 institucioneve në fokus, përkatësisht 382 harta të reja procesi, janë miratuar nga institucionet në fjalë por nuk janë miratuar nga Këshilli i Ministrave. Rrjedhimisht nuk shënohet progres. *Arritjet kundrejt nivelit të synuar për vitin 2018⁴¹ janë për pasojë në nivelin 0%.*

Gjatë vitit 2018, nga ADISA është kryer vlerësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimit në sportelet pritëse ADISA me anë të mekanizmave të ndryshëm. Kështu është kryer **matja e kënaqësisë qytetare me anë të sondazheve të drejtpërdrejta, sondazheve në dalje (Exit Survey), vizitave të Klientit Misterioz dhe të sondazheve online.**


*Niveli i kënaqësisë së qytetarëve në drejtim të ofrimit të shërbimeve është rritur dukshëm, rezultat ky në vijim të sondazheve të drejtpërdrejta, në dalje (Exit Survey), online apo vizitave të Klientit Misterioz të kryera për matjen e kënaqësisë qytetare në sportelet pritëse ADISA. Janë realizuar gjashtë sondazhe për matjen e kënaqësisë qytetare në sportelet pritëse të ZVRPP Tiranë, Qendra Kavajë, Gjirokastrë, Krujë dhe Fier përkatësisht në muajt Shkurt, Maj, Korrik, Gusht dhe Tetor 2018. Në përgjithësi të intervistuarit kanë vlerësuar me **mbi 98% pozitivisht** shërbimet e ofruara nga ZVRPP në muajin Shkurt dhe Tetor 2018 dhe 97% pozitivisht janë vlerësuar shërbimet e ofruara në Qendrën Kavajë. Niveli i kënaqësisë së qytetarëve për periudhën Korrik - Gusht 2018 në Qendrën Krujë dhe Fier është në nivelin 100%. Nga analizimi i të dhënave vihet re një rritje e dukshme e nivelit të kënaqësisë qytetare në të gjithë indikatorët e krahasuar me periudhën para hapjes së zyrave pritëse. Më poshtë paraqitet grafikisht përmirësimi i nivelit të kënaqësisë qytetare sipas indikatorëve të ndryshëm për matjen e performancës për shkallën “shumë të kënaqur”:*

⁴¹ Niveli i synuar për vitin 2018 është 150 harta të prodhuara dhe të miratuara nga Këshilli i Ministrave (referuar Pasaporta e Indikatorëve, fq. 24).

Grafiku 21. Vlerësimi i cilësisë së shërbimit sipas exit survey



Grafiku 22. Vlerësimi i cilësisë së shërbimit sipas Mystery Shopper



Gjatë muajit Qershor 2018 janë zhvilluar **exit survey** me qytetarë dhe përfaqësues biznesesh, të cilët kanë marrë shërbim në sportelet pritëse të institucioneve që ofrojnë shërbimet në ZVRPP Tiranë dhe në Qendrat e Integruara Kavajë, Krujë, Fier dhe Gjirokastrë. Në përgjithësi qytetarët shprehen të kënaqur me cilësinë e ofrimit të shërbimit në nivelin **90%**. Niveli i kënaqësisë me cilësinë e ofrimit të shërbimit në **ZVRPP Tiranë** është **80%**, në **Zyrën Kavajë** është **90%**, në **Zyrën Krujë** është **98%**, në **Zyrën Fier** është **98%** dhe në **Zyrën Gjirokastrë** është **88%**.

Gjatë muajve Mars – Prill 2018, në kuadër të konsulencës “Mystery Shopper, Assessment of performance in central government service delivery”, janë zhvilluar vizita të klientit misterioz për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimit të institucioneve të administratës shtetërore, përfshirë këtu dhe sportelet e shërbimit të administruara nga ADISA në **ZVRPP Tiranë** dhe në **Qendrat e Integruara Kavajë, Krujë, Fier dhe Gjirokastrë**. Në total, ADISA vlerësohet me një indeks prej **90 pikësh** nga 100 pikë në total. Analizuar në nivel zyre, 3 prej tyre që kanë performancë më të lartë dhe kanë arritur standardin e kërkuar dhe këto janë **Qendra e Integruar Krujë (94 pikë)**, **Kavajë (93 pikë)** dhe **Gjirokastrë (93 pikë)**. Ndërsa degët e tjera të cilat kanë performuar afër standardit janë **FO ZVRPP Tiranë (87 pikë)** dhe **Qendra e Integruar Gjirokastrë (81 pikë)**. Sondazhet on-line janë realizuar me votim të hapur për të gjithë qytetarët në faqen zyrtare të ADISA nëpërmjet pyetjes “Si i vlerësoni ndryshimet e kryera nga ADISA në cilësinë e ofrimit të shërbimit?” për FO ADISA ZVRPP Tiranë dhe për Qendrat e Integruara në Kavajë, Krujë, Fier dhe Gjirokastrë. Në përgjithësi, niveli i vlerësimeve online është i lartë. Më së shumti vlerësohen ndryshimet e kryera në Qendrat e Integruara Fier dhe Gjirokastrë.

Duke patur parasysh analizat e mësipërme për matjen e kënaqësisë qytetare në sportelet pritëse në ZVRPP Tiranë dhe në Qendrat e Integruara në Kavajë, Fier, Gjirokastrë dhe Krujë si dhe rezultatet e sondazheve online, ky indikator ka **progres në rritje** krahasuar me periudhat para hapjes së Qendrave të Integruara ADISA dhe me muajt respektivë në të cilët janë zhvilluar sondazhet gjatë vitit 2018.

Arritjet kundrejt nivelit të synuar për vitin 2018⁴² janë realizuar.

Indikatori 8b.	Vlera 2018
Niveli (%) e kënaqshmërisë publike kundrejt cilësisë së ofrimit të shërbimeve	Tendencë në rritje

Duke patur parasysh analizat e mësipërme për matjen e kënaqësisë qytetare në sportelet pritëse në ZVRPP Tiranë, Qendrën e Integruar në Kavajë, Krujë, Gjirokastrë dhe Fier si dhe rezultatet e sondazheve online, ky indikator ka **progres në rritje** krahasuar me periudhat para hapjes së Qendrave të Integruara ADISA dhe me muajt respektivë në të cilët janë zhvilluar sondazhet gjatë vitit 2018. Arritjet kundrejt nivelit të synuar për vitin 2018⁴³ janë realizuar.

Indikatori 8c.	Vlera 2017 ⁴⁴
Shkalla në të cilën politikat për ofrimin e shërbimeve të fokusuara tek qytetari janë miratuar dhe zbatuar në praktikë	3

Sipas raportit të vlerësimit të OECD/SIGMA 2017 shkalla në të cilën politikat për ofrimin e shërbimeve të fokusuara tek qytetari janë miratuar dhe zbatuar në praktikë ka qenë 3 duke shënuar një rritje krahasuar me vlerësimin e vitit 2015, niveli i të cilit ishte 2. Sa i takon vitit 2018, SIGMA nuk ka bërë një vlerësim të këtij indikator.

Përsa i përket **Objektivit 9 “Zhvillimi i një infrastrukture TIK të aftë për të mbështetur veprimtaritë e përditshme të administratës publike dhe rritjen e efikasitetit duke ulur kohën për të aksesuar, përpunuar dhe transmetuar informacionin ndërsa përmirësohet rrjedha e informacionit”** kanë filluar zbatimin 3 produkte nga 5 të parashikuara në total.

Gjatë vitit 2018 në drejtim të realizimit të këtij objekti më poshtë do të përmendim shkurtimisht disa nga arritjet konkrete për periudhën raportuese:

Janë 99 institucione qendrore dhe 61 njësitë e qeverisjes vendore që ofrojnë një gamë të gjerë kategorish shërbimesh elektronike duke filluar nga të punësuarit, të papunët, drejtuesit e mjeteve, pronarët e pronave, nxënësit, pensionistët, qytetarët shqiptarë jashtë vendit por edhe ata të huaj që interesohen për të marrë shërbime në Shqipëri e deri tek bizneset dhe vetë punonjësit e administratës publike.

Gjatë periudhës Janar - Dhjetor 2018 është lidhur dhe një institucion tjetër në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit duke e çuar numrin total të institucioneve të lidhura në 49 krahasimisht me 47 që ishin në vitin 2017. Platforma Qeveritare e Ndërveprimit është arkitektura bazë që mundëson ndërlidhjen e regjistrave elektronikë me njëri-tjetrin dhe shkëmbimin e të dhënave në kohë reale në formë të sigurt dhe të besueshme duke garantuar shërbime elektronike për qytetarët,

⁴²Niveli i synuar për vitin 2018 është tendencë në rritje (referuar Pasaporta e Indikatorëve, fq. 25).

⁴³Niveli i synuar për vitin 2018 është tendencë në rritje (referuar Pasaporta e Indikatorëve, fq. 25).

⁴⁴Shih OECD/SIGMA Raporti Vlerësimit 2017 “Parimet e Administratës Publike” fq. 108


bizneset dhe administratën publike. Në të qarkulluan gjatë vitit 2018 mbi 52 milionë transaksione mes sistemeve të lidhura.

Portali qeveritar e-Albania, projekti i qeverisë shqiptare në themel të së cilit është bashkëveprimi institucional online, është shembulli tipik i dixhitalizimit të shërbimeve shtetërore ku mundësohen mjete lehtësuese komunikimi të drejtpërdrejta të individëve të autentifikuar në sistem dhe shmangen pengesat e një spektri të gjerë. Qeveria shqiptare, si promotore e transformimit të shërbimeve fizike drejt shërbimeve online, e ktheu portalin e-Albania në shembull dhe arriti të ndërtojë një imazh serioz të shtetit dhe të kthejë besimin e qytetarëve tek institucionet.

Portali unik qeveritar e-Albania ka ofruar rreth **1570** shërbime elektronike nga të cilat **591 shërbime elektronike** ose 42 herë më i lartë se në vitin 2013. Aktualisht janë regjistruar **333,378** përdorues të rinj dhe në total prej vitit 2013 përllogariten **726,280 (ose 14 herë më shumë se 2013)** përdorues të regjistruar. Nga përdoruesit e regjistruar për periudhën raportuese nga 2013, 5% e tyre i përkasin profilit biznes dhe 95% e të regjistruarve i përkasin profilit qytetar. Gjatë vitit 2018 janë regjistruar 50% më shumë përdorues se sa numri total i të regjistruarve gjatë gjithë vitit të kaluar (151,439 të regjistruar gjatë vitit 2017). Për këtë periudhë raportimi, 3% e përdoruesve i përkasin profilit biznes dhe 97% e të regjistruarve i përkasin profilit qytetar.

Faqet e portalit janë klikuar 10,361,520 herë gjatë vitit 2018 dhe një përdorues ka shpenzuar mesatarisht 00:05:46 minuta duke shfletuar portalin. Janë 33.19 % e numrit total, përdoruesit që rikthehen në portal.

Grafiku 23. Përdoruesit e portalit e-Albania sipas grupmoshës



Gjithashtu në **Platformën Ndërqeveritare të Ndërveprimit** së fundmi janë shtuar 22 shërbime dedikuar të huajve që synojnë të punojnë në Shqipëri të cilat u mundësojnë atyre të kryejnë online aplikimin për leje pune.

Në drejtim të lehtësimit të aksesit për qytetarët dhe bizneset në shërbimet elektronike u ndërmor një iniciativë e rëndësishme e ofruar nga portali unik qeveritar e-Albania e cila ishte **vula dixhitale** dhe **moduli i administratës publike** për nxjerrjen e dokumenteve administrative për qytetarin. Portali e-Albania përdoret nga punonjësit e administratës publike për të marrë vërtetime dhe

dokumente të cilat gjenden si shërbime të portalit (me vulë dixhitale) për plotësimin e dokumentacionit shoqërues të shërbimit të kërkuar nga qytetari. Këto dokumente nuk i kërkojnë më vetë qytetarit gjatë marrjes së një shërbimi publik.

Deri në fund të vitit 2018 janë **33** dokumente me vulë që ofrohen në modul për nëpunësit e administratës publike që merren me procedurat e ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarëve me qëllim përmirësimin e disponueshmërisë, cilësisë dhe transparencës së shërbimeve publike si dhe reduktimin e kohës së zbatimit të procedurave dhe kostove të administratës publike. **Mbi 2.5 milionë dokumente** me vulë elektronike janë përfituar lehtësisht nga qytetarët dhe bizneset duke shmangur përfundimisht korrupsionin dhe vonesat. Aktualisht janë **140 institucione** dhe **mbi 7300 përdorues** të konfiguruar në modul për gjenerimin e dokumenteve me vulë elektronike. Për të lehtësuar përdorimin e portalit e-albania nga qytetarët dhe bizneset, portali unik qeveritar e-albania erdhi i ridizenuar plotësisht, më estetik, më i lehtë dhe më praktik. E gjithë ndërfaqja e portalit është ndryshuar duke nxjerrë në pamje të parë kategoritë e shërbimeve elektronike (familja, arsimi, puna, shëndetësia dhe mbrojtja sociale, kontributet dhe pensioni, biznesi im, leje dhe licenca etj.), të cilat e bëjnë më të lehtë dhe më të shpejtë gjetjen e shërbimeve.




Figura 4. Paraqitje e portalit me ndryshimet

Klikimi i çdo kategorie liston tashmë jo vetëm listën e shërbimeve që i përkasin asaj por një listë me nënkategori që e orientojnë përdoruesin në gjetjen më shpejt të shërbimit që kërkon. Për çdo shërbim specifikohet edhe tipi i përdoruesit së cilit i dedikohet (psh. për qytetarë, për biznese, për qytetarë dhe biznese), karakteristikë e bërë e dallueshme edhe me ngjyra. Çdo kategori dhe nënkategori ka një ikonë të dedikuar të cilat janë dizenuar duke përdorur si shembull ikona universale për të mundur një perceptim sa më të gjerë që në pamje të parë.

Të gjitha shërbimet elektronike janë ridizenjuar dhe rikrijuar, jo vetëm për t'u përshtatur vizualisht me formatin e ri të portalit por edhe për t'u përmirësuar nga ana funksionale duke rritur performancën.

Indikatori 9a.	Vlera 2018
Sisteme të përmirësuara të IT-së për ofrimin e shërbimeve	0

Gjatë vitit 2018, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, e zgjeruara përmes VKM-së Nr. 673, datë 22.11.2017, ka punuar për hartimin e analizës së situatës (*ku përfshihej analiza e sistemeve ekzistuese dhe përmirësimet e tyre si dhe identifikimi i nevojave për ngritje sistemesh të reja apo dixhitalizime*). Në vijim janë hartuar termat e referencës për një sërë projektesh që përfshijnë përmirësime apo ngritje sistemesh të reja të cilat janë prokuruar dhe janë lidhur si kontrata gjatë vitit 2018. Vlera e këtij indikatori është 0 pasi këto kontrata janë ende në proces implementimi dhe pritet të përfundojnë gjatë vitit 2019. Informacioni mbi to do të jepet pas përfundimit të implementimeve, në raportet në vijim.

Indikatori 9b.	Vlera 2018
Shkalla në të cilën janë të zbatueshme parakushtet politike dhe administrative për ofrimin e shërbimeve elektronike (Indikatori i SIGMA-s).	Tendencë në rritje

Përsa i përket **Objektivit 10 “Rritja e efikasitetit dhe përgjegjshmërisë së nëpunësve publikë”** janë parashikuar gjithsej 3 aktivitete prej të cilave 2 kanë nisur zbatimin gjatë vitit 2018.

Në kuadër të Reformës në Administratën Publike, si një ndër pesë prioritetet për hapjen e negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Europian, me theksin kryesor tek një administratë profesionale dhe e bazuar në meritë, duke synuar forcimin e kapaciteteve dhe përmirësimin e ofrimit të shërbimeve tek qytetarët dhe bizneset, gjatë vitit 2018 qeveria ndërmori një iniciativë të re dhe ambicioze me hartimin e Programit për Administratën që Duam⁴⁵. Ky program ka në fokus nëpunësit e administratës publike si një ndër komponentët kryesorë dhe baza e zbatimit të të gjitha reformave të ndërmarra nga qeveria. Ky program është në linjë me dokumentin e rëndësishëm strategjik të miratuar nga Qeveria Shqiptare, Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike 2015-2020, që vë theksin tek reformimi i administratës dhe pëmbushja e detyrimeve për integrimin në BE, me aktivitete konkrete dedikuara rritjes dhe forcimit të kapaciteteve të administratës publike në Shqipëri, përmes modernizimit të saj dhe forcimit të institucioneve kyçe.

Programi i Administratës Publike përfshin një tërësi masash dhe aktiviteteve të kombinuara dhe të integruara, përfitimet e të cilave ndërlidhen duke siguruar sinergji dhe duke i shërbyer arritjes së përfitimeve më të qëndrueshme dhe më afatgjata në kuadër të përmirësimit të performancës së

⁴⁵ Urdhri i Kryeministrit nr. 125, datë 31 Korrik 2018

administratës publike. Ky program fokusohet jo vetëm në aftësitë dhe zotësitë e punonjësve për të kryer detyrat, por edhe në qëndrimet, motivimin dhe angazhimin për të vepruar në mënyrën e duhur.

Programi përbëhet nga katër komponentë kryesorë të cilët përkojnë me fushat në të cilat u konsiderua e nevojshme ndërhyrja, e konkretisht:

1. **Orientimi i administratës**⁴⁶ – me aktivitetet e përfshira në këtë komponent synohet të qartësohen dhe njihen punonjësit me qëllimin, vizionin, misionin, vlerat dhe parimet e administratës, qëllimet strategjike dhe prioritetet e qeverisë dhe institucionit ku bëjnë pjesë. Më konkretisht, orientimi synon t'i bëjë të qartë punonjësve të administratës përse janë aty (arsyen) çfarë duan të arrijnë dhe mbi ç'baza dhe principe duhet të veprojnë.
2. **Aftësimi i Administratës**⁴⁷ – me aktivitetet e parashikuara në këtë komponent synohet të rriten kapacitetet e punonjësve të administratës publike me qëllim që të jenë të qartë mbi çfarë duhet të bëjnë si dhe të kenë formimin dhe njohuritë e nevojshme për të realizuar një funksion, detyrë apo punë të caktuar.
3. **Motivimi i Administratës**⁴⁸ – me aktivitetet e parashikuara në këtë komponent synohet të garantohet niveli i duhur i përkushtimit, angazhimit dhe ndjenjës së përkatësisë. Në këtë komponent parashikohen masa për rritjen e motivimit të punonjësve të administratës publike, nëpërmjet promovimit të punës në grup dhe bashkëpunimit, shpërblimeve apo ofrimit të mundësive për zhvillim të mëtejshëm profesional dhe rritjes në karrierë apo përgjegjësi.
4. **Ndërveprimi i Administratës**⁴⁹ – me aktivitetet e parashikuara në këtë komponent synohet fuqizimi i bashkëpunimit dhe ndërveprimit të strukturave të administratës mes tyre dhe me publikun, duke siguruar një bashkërendim dhe koordinim të integruar të punës së administratës publike si një njësi e vetme.

Viti 2018 përkoi me fazën e parë apo “immediate” të këtij programi gjatë së cilës u vendosën linjat kryesore mbi të cilat programi do të zhvillohet gjatë shtrirjes së plotë të tij tre vjeçare. Kjo fazë u përqendrua në elementët për të cilat u evidentua nevoja për ndërhyrje të menjëhershme e më konkretisht:

→ Janë marrë masat për **orientimin e administratës** dhe rritjen ndërgjegjësimit sa i takon kuptueshmërisë dhe promovimit të programit e përfitimeve të tij brenda administratës publike. Për këtë arsye janë realizuar një numër takimesh shpjeguese me nivele të ndryshme të zyrtarëve publikë për të përfshirë të gjitha kategoritë në aktivitetet e programit, qëllimet dhe përfitimet e tij. Gjithashtu është përgatitur paketa e parë e orientimit në lidhje me prioritetet e qeverisë, si një ndër aktivitetet e para të parashikuara në këtë komponent.

⁴⁶ Stuktura drejtuese e këtij komponenti është Delivery Unit në Kryeministri.

⁴⁷ Stuktura drejtuese e këtij komponenti është Shkolla Shqiptare e Administratës Publike.

⁴⁸ Stuktura drejtuese e këtij komponenti është Departamenti i Administratës Publike.

⁴⁹ Stuktura drejtuese e këtij komponenti është Agjencia për Dialog dhe Bashkëqeverisje.

- Duke synuar **aftësimin e administratës**, si dhe rritjen e mëtejshme të kapaciteteve të saj, vëmendja u përqendrua tek punonjësit e institucioneve që ofojnë shërbime, punonjësit e Front Office⁵⁰ të cilët kanë një kontakt të drejtpërdrejtë me qytetarët, duke zhvilluar trajnime për “Soft Skills”⁵¹ me mbështetjen e Bashkimit Evropian. Gjithashtu, gjatë vitit 2018, me mbështetjen e Këshillit të Evropës dhe Kooperacionit Zvicerian, u zhvillua në bashkëpunim me ASPA trajnimi për Leadership i rreth 100 drejtuesve të lartë të administratës publike.
- Në drejtim të rritjes së **motivimit të administratës publike**, Departamenti i Administratës Publike filloi analizën e procesit të vlerësimit të rezultateve në punë, me qëllim (i) rritjen e objektivitetit të këtij procesi në funksion të identifikimit të punonjësve më të mirë të administratës publike, e më pas motivimit dhe shpërblimit të tyre të mëtejshëm, si dhe nga ana tjetër (ii) identifikimin e punonjësve që kanë arritur rezultate të ulëta me qëllim adresimin e nevojave të tyre për trajnim.
- Në drejtim të rritjes së **ndërveprimit së administratës**, u ngritën rrjetet profesionale, si një ndër format më efektive të zhvillimit profesional pasi me rritjen e ndërveprimit midis zyrtarëve të fushave të njëjta, sigurohet dhe aftësimi i tyre në kryerjen e funksioneve dhe detyrave të përditshme.

Zhvillimi i një administrate publike që siguron shërbime me cilësi të lartë për qytetarët dhe bizneset në mënyrë transparente, efektive, dhe efikase, nëpërmjet përdorimit të teknologjive moderne dhe shërbimeve inovative dhe përputhet me kërkesat e integritetit evropian, nëpërmjet nëpunësve civilë të paanshëm, profesionalë dhe të përgjegjshëm, pjesë e strukturave efëcente është dhe do të vijojë të mbetet në fokus të qeverisë shqiptare dhe të të gjithë aktorëve, si një ndër 5 prioritetet për çeljen e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian, proces i cili mund të arrihet vetëm nëpërmjet një administratë publike profesionale dhe të përkushtuar si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal.

Indikatori 10a.	Vlera 2017
-----------------	------------

Shkalla në të cilën kuadri ligjor për administrimin e mirë është miratuar dhe zbatuar në praktikë (Indikatori i SIGMA-s.)	3
---	---

Sipas raportit të vlerësimit të OECD/SIGMA 2017 shkalla në të cilën kuadri ligjor për administrimin e mirë është miratuar dhe zbatuar në praktikë qenë 3 duke shënuar një rritje krahasuar me vlerësimin e vitit 2015, niveli i të cilit ishte 2. Ky vlerësim lidhet kryesisht me miratimin e Kodit të ri të Procedurave Administrative dhe adoptimin e një sërë procedurash standarde të ofrimit të shërbimeve. Sa i takon vitit 2018, SIGMA nuk ka bërë një vlerësim të këtij indikatori.

Përsa i përket **Objektivit 11 “Rritja e kontrollit mbi veprimtarinë e administratës publike, garantimi i të drejtave të qytetarëve dhe aksesit në informacion”**, janë parashikuar gjithsej 9 aktivitete të cilat duhet të zbatohen dhe janë realizuar plotësisht 4 aktivitete.

⁵⁰ Gjatë 2018 u trajnuan rreth 1260 punonjës të zyrave Front Office me mbështetjen e projektit IPSD të financuar nga Bashkimi Evropian.

⁵¹ Trajnimet për Soft Skill përfshijnë trajnime për Etikën dhe Sjelljen, Komunikimin, Kujdesin ndaj klientit.

Gjatë vitit 2018 Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka vijuar punën lidhur me zbatimin dhe monitorimin e ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” kryhet nëpërmjet monitorimit të elementëve të ndryshëm të ligjit si p.sh. numri i autoriteteve publike që kanë hartuar programet e transparencës, numri i koordinatorëve të caktuar nga autoritetet publike, përditësimi i regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve, numri i ankesave të shqyrtuara, hetimet e kryera, seanca dëgjimore të zhvilluara si dhe vendimet e dhëna.

Gjatë vitit 2018, Zyra e Komisionerit jo vetëm ka monitoruar faqet zyrtare të Autoriteteve Publike por ka kryer inspektive në terren si dhe ka kërkuar informacion lidhur me përmbushjen e detyrimeve që burojnë nga Ligji nr. 119/2014, si:

- *Publikimi i programeve të transparencës;*
- *Caktimi i koordinatorit për të drejtën e informimit;*
- *Publikimin e regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve.*

Nga monitorimi i autoriteteve publike ka rezultuar se **219** autoritete publike kanë miratuar dhe publikuar programin e transparencës; **331** autoritete publike kanë caktuar koordinator për të drejtën e informimit dhe **178** Autoritete Publike kanë publikuar regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve.

Nga monitorimi i autoriteteve publike për vitin 2018 ka rezultuar se institucionet të cilat kanë një program të plotë dhe të përditësuar transparence janë ***institucionet e pavarura***. Gjithashtu, institucionet e pavarura kanë të njëjtët koordinatorë që kanë caktuar që me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e Informimit”. Numri i kërkesave për informim të trajtuara nga këto institucione gjatë vitit 2018 është **425** ndërsa numri i kërkesave të refuzuara **6**.

Në lidhje me pushtetin vendor, Zyra e Komisionerit vlerëson se niveli i transparencës së bashkive shënon përmirësime. Taslmë të gjitha bashkitë kanë caktuar koordinatorët e të drejtës për informim dhe numri i kërkesave për informacion publik të trajtuara nga bashkitë gjatë vitit 2018 është **7244**, ndërsa numri i kërkesave të refuzuara është **367**.

Zyra e Komisionerit vlerëson se niveli i transparencës për ***institucionet e pushtetit qendror*** shënon përmirësime në krahasim me vitin 2017 ku për shkak të ndryshimeve në fushat e kompetencave të secilës ministri, pati një përkeqësim të dukshëm lidhur me zbatimin e detyrimeve që burojnë nga ligji “Për të drejtën e informimit”. Megjithatë nga monitorimi vijnë të konstatohen problematika të cilat lidhen me faktin se programet e transparencës nuk janë të përditësuar, evidentohet mungesë e dokumentave të cilat duhet të jenë të publikuara (si buxheti, prokurimet dhe raportet e auditit).

Gjatë vitit 2018, koordinatorët e të drejtës për informim të ministrive kanë trajtuar gjithsej 728 kërkesa për informacion publik dhe vetëm 9 prej tyre janë refuzuar.

Në zbatimin të Ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit” gjatë vitit 2018, pranë Zyrës së Komisionerit u depozituan **820** ankesa prej të cilave **622** janë zgjidhur me ndërmjetësim. Për **37**

ankesa, Komisioneri është shprehur me “Vendim”. Më tej, **116** ankesa kanë rezultuar jashtë objektit, **9** ankesa kanë qenë jashtë afatit dhe **17** ankesa kanë rezultuar të paplota.

Fakti që pjesa më e madhe e ankesave janë zgjidhur me ndërmjetësim tregon efektivitetin e ndërhyrjes së Zyrës së Komisionerit. Pjesa më e madhe e ankesave të shqyrtuara nga Zyra e Komisionerit kanë qenë ankesa të drejtura nga qytetarët. Konkretisht **656** ankesa janë depozituar nga qytetarët ndërsa **164** ankesa janë depozituar nga Organizata JoFitimprurëse (OJF). Fakti që numri më i madh i ankesave vijnë nga qytetarët është një tregues mjaft i mirë i impaktit të ndërgjegjësimit të qytetarëve mbi të drejtën e informimit.

Zyra e Komisionerit ka realizuar **93** hetime administrative në fushën e të drejtës për informim me synim verifikimin e ankesave të depozituara. Gjithashtu janë dhënë **37** vendime për Autoritetet Publike prej të cilave **30** vendime urdhërimi, **3** vendime rrëzimi si dhe **4** vendime me sanksione gjobe. Gjatë këtij viti janë realizuar **29** seanca dëgjimore. Zyra e Komisionerit ka realizuar masat e parashikuara në përputhje me afatet e përcaktuara në plan veprimi si dhe është në proces në përputhje me parashikimet kohore, për ato masa për të cilat është lënë një hark më i gjatë kohor për realizimin e tyre.

Ka përfunduar procesi i monitorimit të institucioneve të varësisë së ministrive dhe aktualisht Zyra e Komisionerit është duke përpunuar rezultatet e këtij monitorimi. Materiali përfundimtar do të pasqyrojë problematikat e evidentuara si dhe do t'i përcillet autoriteteve publike kompetente me qëllim marrjen e masave përkatëse. Rezulton gjithashtu që është realizuar plotësisht aktiviteti mbi hartimin e programeve model të transparencës për pushtetin vendor. Me urdhrin nr. 211, datë 11.09.2018 Komisioneri ka miratuar programin model të transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore⁵².

Ky program është publikuar dhe në fletoren zyrtare nr. 133 datë 17.09.2018. Gjithashtu është zhvilluar dhe trajnimi i koordinatorëve të të drejtës për informim për njësitë e vetëqeverisjes vendore në bashkëpunim me IDM dhe projektin STAR 2 për të gjithë koordinatorët e bashkive. Është përfunduar gjithashtu dhe rishikimi i strukturës së KDIMDP me synim forcimin e kapaciteteve monitoruese për zbatimin e ligjit për të drejtën e informimit ku me anë të Vendimit të Kuvendit Nr. 86 datë 19.07.2018 është miratuar struktura e re e Zyrës së Komisionerit.

Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, kanë përfunduar implementimin e instrumentit të vetëvlerësimit të transparencës në Kryeministri, Institucionin e Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Parlamenti dhe në të gjitha ministrinë dhe institucionet e pavarura. Fillimisht u zhvilluan trajnime për të gjithë koordinatorët e të drejtës për informim me synim shpjegimin e instrumentit të vetëvlerësimit e më pas u hartua raporti përfundimtar dhe rekomandimet për secilin institucion.

⁵² http://www.idp.al/wp-content/uploads/2018/09/Programi_i_Transparences_Pushteti_Vendor.pdf

Në kuadër të aktiviteteve për forcimin e kapaciteteve, në datat 27-28 Shkurt 2018, Zyra e Komisionerit në bashkëpunim me TAIEX (Technical Assistance and Information Exchange instrument of the European Commission) zhvilluan trajnimin e dytë, me temë “Harmonizimi i legjislacionit kombëtar me Direktivën 680/2016”. Ndër çështjet kryesore të trajnimit ishin ato për njohjen dhe respektimin e të drejtave të qytetarëve kur ata janë subjekt i transferimit të të dhënave për qëllime të hetimit policor apo gjyqësor si dhe kategoritë e të dhënave që transferohen në raste të tilla.

Për vitin 2018, **numri i ankesave ka pasur tendencë në rritje** (indikator 11.a). Sikurse është parashikuar dhe në pasaportën e indikatorëve nga **684** ankesa të shqyrtuara në vitin 2016, në vitin 2017 janë shqyrtuar **560** ankesa dhe në vitin 2018 numri i ankesave të trajtuara është **820**.

Për sa i përket pjesës së indikatorit lidhur me numrin e sanksioneve të aplikuara nga ana e Komisionerit në raport me numrin e inspektimeve të kryera pranë autoriteteve publike, sikurse parashikohet në pasaportën e indikatorëve, ky raport për Vitin 2018 është 0.04%, duke pësuar rënie krahasuar me vitin 2017. Një nga sfidat kryesore të Zyrës së Komisionerit është rritja e përgjegjshmërisë së autoriteteve publike duke nritur kontrollin mbi veprimtarinë e administratës publike në garantimin e të drejtave të qytetarëve dhe aksesit në informacion.

Indikatori 11a.	Vlera 2018
Numri i ankesave të paraqitura çdo vit pranë Komisionerit përgjegjës për lirinë e informimit	820

Gjatë kësaj periudhe, Institucioni i Avokatit të Popullit ka adresuar në total 171 rekomandime drejtuar organeve të Administratës Publike duke përfshirë atë qendrore dhe vendore. Nga numri total i rekomandimeve rezulton se:

- **93 rekomandime janë pranuar;**
- **17 rekomandime janë refuzuar;**
- **5 rekomandime janë pa përgjigje;**
- **56 rekomandime në proces.**

Pra sic rezulton nga të dhënat e mësipërme, numri i rekomandimeve të regjistruara për vitin 2018 është 171 por 56 prej tyre janë në proces që do të thotë se për këto rekomandime ende nuk kanë kaluar afatet procedurale për të konsideruar nëse janë pranuar apo refuzuar, zbatuar apo pa zbatuar, me apo pa përgjigje, duke qënë se janë dërguar në fund të vitit 2018 apo në fillim të vitit 2019 për inspektime të kryera në 2018.

Në këto kushte, për të mundësuar raportimin e të dhënave realiste dhe gjenerimin e indikatorit real, përlllogaritja e indikatorit do të realizohet mbi bazën e rekomandimeve faktike (**115 rekomandime**) të cilët efektivisht u janë dërguar subjekteve përkatëse dhe janë ezauruar afatet procedurale për të konkluduar lidhur me pranimin apo zbatimin e tyre nga institucionet.

Në përfundim, nisur nga analiza e statistikave të mësipërme, për vitin 2018 evidentohet se ka një **rritje të numrit të rekomandimeve të pranuar në tërësi nga institucionet e Administratës Publike si dhe ka një rritje në përqindje e rekomandimeve të zbatuara**. Ndërkohë që edhe lidhur me rekomandimet pa përgjigje rezulton se për vitin 2018 janë 5 rekomandime pa përgjigje. Pra referuar raportit midis rekomandimeve pa përgjigje dhe rekomandimeve të adresuara në total nga Avokati i Popullit rezulton se 4,3% e rekomandimeve të adresuara nuk kanë përgjigje. Vlera e mëposhtme shënon rritjen krahasimisht me 16.7% për vitin 2017.

<i>Indikatori 11b.</i>	Vlera 2018
Përqindja e rekomandimeve të zbatuara nga institucionet mbikëqyrëse të institucioneve të pushtetit qendror në dy vitet e kaluara.	81.7%

Nga numri i rekomandimeve të adresuara në total (115), rezulton se 93 prej tyre janë pranuar, dhe 76 prej rekomandimeve të pranuar kanë gjetur zbatim të plotë. Pra, referuar raportit të rekomandimeve të pranuar me rekomandimet e zbatuara plotësisht, rezulton se rreth 81.7% e rekomandimeve të pranuar kanë gjetur zbatim të plotë nga institucionet përkatëse.

V. Sfidat kryesore për zbatimin e Strategjisë në 2019

Sfidat kryesore në vijim të zbatimit të strategjisë mbeten:

- ***Vijimi i zbatimit të Planit të ri të aktiviteteve për periudhën 2019-2020***, në zbatim të Strategjisë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2015-2020,
- ***Realizimi i plotë i reformave të parashikuara në Strategji*** dhe mbi të gjitha përmbushja e objektivave të parashikuara për të patur në fund të vitit 2020 një Strategji e cila mund të vlerësohet si e zbatuar mbi nivelin 80% të saj.
- ***Përmirësimi i planifikimit dhe koordinimit të politikave***, përmirësimi i procesit të konsultimit publik duke bërë të mundur përfshirjen aktive dhe cilësore, vënia në zbatim e vlerësimit të ndikimit rregullator, procesi i de-rregullimit apo edhe ristrukturimi i agjencive dhe institucioneve të varësisë në pikëpamje të përmirësimit të ofrimit të shërbimeve, struktura e re e pagave, unifikimi i procedurave, funksionaliteti i plotë i HRMIS, forcimi i kapaciteteve të ASPA, zhvillimi i infrastrukturës TIK dhe garantimi i të drejtave të qytetarëve etj. mbeten ndër sfidat kryesore përgjatë vitit 2019 e më tej.
- ***Një nga sfidat mbetet dhe prezantimi i hapur i problemeve që ndeshen në zbatimin e strategjive.*** Është e nevojshme pasqyrimi i sfidave dhe risqeve të mundshme në mënyrë sistematike dhe gjithëpërfshirëse në raportet vjetorë të monitorimit të strategjisë në të gjitha nivelet teknike, menaxheriale dhe politike. Kjo kërkon një përmirësim të kulturës së punës së administratës shqiptare: kulturën e analizës dhe evidentimit të problematikave në mënyrë sa më objektive.
- ***Reforma e administratës publike duhet të vijojë të mbetet në fokus dhe vëmendje të të gjithë aktorëve*** si një ndër 5 prioritetet për çeljen e negociatave për anëtarësimin në Bashkimin Evropian. Suksesi i këtyre negociatave mund të arrihet vetëm nëpërmjet një administratë publike profesionale dhe të përkushtuar si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal.